

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIV i botimit, nr. 268, Shkurt 2026

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Konferenca përkujtimore shkencore kushtuar dyvjetorit të vdekjes së Prof. Emeritus Ignazio Parrino

Profesot Emeritus Ignazio Parrino pedagog i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Palermos, albanolog me njohje ndërkombëtare. Me datën 11 shkurt 2026, në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave u organizua një Konferencë përkujtimore shkencore kushtuar Prof. Emeritus Injac Parrino nga Palazzo Adriano (Pallaci në arbërisht), me pjesëmarrjen e familjarëve të Prof. Parrinos (bashkeshortes dhe dy fëmijëve) dhe kryetarit të Komunitetit të Pallacit, Dr. Nikola Granà. Konferenca u përgatitë dhe u zhvillua me angazhimin dhe nën drejtimin e drejtpërsëdrejti të studiuesit të njohur të arkivave, Dr. Mark Palnikaj, në bashkëpunim me institucione akademike në Tiranë dhe Shkodër.

### ROZAFI DHE SHIRGJI, MITI VENDAS NGA HISTORIA E LARGËT!

Emrat lidhen shpesh me Rosafa (e shkruar edhe Resapha ose Rusafa), qytetin e shkretëtirës në Sirinë e sotme, ku u martirizua Sergiusi dhe që më vonë u riemërua Sergiopolis, për nder të tij. Sergius dhe Bacchus janë shenjtorët më të "çiftuar". Në hagiografinë e tyre, ata ishin komandantë romakë dhe "vëllezër armësh" që refuzuan t'i bënin fli Jupiterit. Bacchus vdiq i pari nën tortura dhe shpirti i tij thuhet se iu shfaq Sergiusit, për ta inkurajuar atë të duronte ekzekutimin e tij të fundit në Rosapha. Në studimet moderne, marrëdhënia e tyre shpesh përmendet në diskutimet rreth adelphopoiesis (një rit "vëllezërimi"), gjë që i ka çuar ata të bëhen ikona të rëndësishme në kontekste të ndryshme historike dhe kulturore.

**Kisha e Shirgjit:** E vendosur pranë Shkodrës, kjo rrënoje e shekullit të XIII ishte fillimisht Abacia e Shën Sergjit dhe Shën Bakut (Kisha e Shën Shirgjit dhe Bakut). Për shekuj me radhë, ishte një vend i rëndësishëm pelegrinazhi si për katolikët ashtu edhe për të krishterët ortodoksë. Të tilla u ngritën në Himarë dhe Prizren. Në Konstandinopojë (Stambolli i sotëm) u ngrit Kisha e Shën Sergjit dhe Bakut, e ndërtuar...

6

### NJË HAP I RËNDËSISHËM DREJT NJË SHKOLLE MË E GJITHËPËRFSHIRËSE

PROMOVHET MONOGRAFIA "MENAXHIMI I KLASËS NË SHKOLLIMIN GJITHËPËRFSHIRËS" NË UNIVERSITETIN "LUIGJ GURAKUQI"

Të jesh pjesë e një promovimi libri që trajton shkollimin gjithëpërfshirës nuk është thjesht një përvojë akademike, por edhe një moment reflektimi profesional dhe njerëzor.

Më 9 shkurt, pata kënaqësinë të jem e pranishme në ambientet e Bibliotekës Shkencore të Universitetit "Luigj Gurakuqi", ku u zhvillua promovimi i monografisë "Menaxhimi i Klasës në Arsimin Gjithëpërfshirës", një botim me vlerë të veçantë për fushën e pedagogjisë speciale dhe shkollimit gjithëpërfshirës në Shqipëri.

Autoret, Dr. Arlinda Hallunovi Ymeri, Doktore Shkencash në Psikologji dhe zv. Dekane në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, si dhe MSc. Erudita Fshazi, psikologe dhe pedagoge e jashtme, sollën përpara bashkësisë akademike, arsimor dhe profesional një vepër që ndërthur thellësinë teorike me orientime konkrete për praktikën në klasë. Që në momentet e para, u ndje se ky aktivitet ishte thjesht një prezantim libri, por një hapësirë dialogu ...

4

### LIN DELIJA, ARTI SI NDËRGJEGJE DHE FAT NJERËZOR

3

TONIN GJURAJ


Rektori i Universitetit

"Luigj Gurakuqi" të Shkodrës

Figura e artistit shkodran në kryqëzimin e etikës, estetikës dhe kujtesës kulturore, një model orientimi për universitetin dhe shoqërinë shqiptare...

Sot, në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", jemi mbledhur për të rikthyer në vetëdijen tonë kulturore një figurë që tejkalon përmasat e historisë së artit: Lin Delija — si fat njerëzor, si ndërgjegje morale, si simbol kulture dhe si model etik dhe estetik njëkohësisht.

I lindur në Shkodër, në një qytet me traditë të pasur shpirtërore, kulturore dhe intelektual, Lin Delija u formua në një mjedis ku arti, feja, humanizmi dhe dija bashkëjetonin natyrshëm. Rruga e jetës së tij u ndërta mbi përvojën e mërgimit, të ndarjes dhe të vetmisë, duke e shndërruar krijimtarinë e tij në dëshmi të thellë njerëzore dhe në shprehje të një etike të përjetuar.



# Konferenca përkujtimore shkencore kushtuar dyvjetorit të vdekjes së Prof. Emeritus Ignazio Parrino

Profesot Emeritus Ignazio Parrino pedagog i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Palermos, albanolog me njohje ndërkombëtare.

Me datën 11 shkurt 2026, në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave u organizua një Konferencë përkujtimore shkencore kushtuar Prof. Emeritus Injac Parrino nga Palazzo Adriano (Pallaçi në arbërisht), me pjesëmarrjen e familjarëve të Prof. Parrinos (bashkeshortes dhe dy fëmijëve) dhe kryetarit të Komunës së Pallaçit, Dr. Nikola Granà.

Konferenca u përgatitë dhe u zhvillua me angazhimin dhe nën drejtimin e drejtpërsëdrejti të studiuesit të njohur të arkivave, Dr. Mark Palnikaj, në bashkëpunim me institucione akademike në Tiranë dhe Shkodër.

Pas fjalës përshëndetëse të Dr. Mark Palnikaj, e mori fjalën Dr. Nikollë Loka që mbajti ligjëratën "Kontributi i Prof. Emeritus Ignazio Parrino në shkencat albanologjike".

Prof. As. Dr. Evalda Paci, drejtore e Departamentit të Studimeve letrare në Institutin e Gjuhësisë dhe letërsisë (Akademia e Shkencave) mbajti ligjëratën "Rreth kontributeve historiografike të Ignazio Parrinos";

Prof. Dr. Nertila Haxhia Ljarja dhe Dr. Ermira Alija nga Universiteti i Shkodrës mbajtën ligjëratën "Ignacio Parrino dhe origjinat dokumentare të kulturës siculo-shqiptare";

Dr. Mark Palnikaj mbajti ligjëratën "Kontributi i Prof. Emeritus Ignazio Parrino për studimet shqiptare në arkivat italiane".

Nëpërmjet ligjëratave u theksua, se Prof. Emeritus Ignazio Parrino u angazhua në gjithë jetën e tij, për gjuhën, historinë dhe kulturën shqiptare.

Nga këto ligjëratat doli se, Prof. Parrino është një nga studiuesit më të shquar arbëreshë të albanologjisë, një personalitet i njohur dhe i respektuar në botën akademike dhe shkencore për kontributet e tij në fushën e arkivistikës, gjuhësisë, historisë, kulturores dhe studimeve arbëreshë.

Me një karrierë të gjatë dhe të pasur, Ai ka ndikuar në thellimin e kuptimit të marrëdhënieve historike, kulturore dhe gjuhësore mes Shqipërisë dhe bashkësisë arbëreshë të Italisë.

Injac Parrino ka pasur bashkëpunim të suksesshëm me albanologët Giuseppe Valentini dhe Ernest Koliqi. Ky bashkëpunim e ndihmoi që ai të thellohej më tej në fushën e albanologjisë dhe kërkimeve historike lidhur me Shqipërinë dhe Gjergj Kastriotin.

Libri "Papa Kalisti III, Skënderbeu, Shqipëria dhe Kryqezata: 1455-1458", me autorë Giuseppe Valentini, Matteo Sciambran, Ignac Parrino bazohet në doku-

mente dhe dëshmi të vlefshme nga arkivat e Vatikanit, të cilat hedhin dritë mbi përpjekjet e bashkërenduara ndërmjet Papës dhe Skënderbeut. Këto burime përmbajnë korrespondencë, udhëzime dhe vendime të rëndësishme që dëshmojnë përkushtimin e Kalistit III dhe vendosmërinë e Skënderbeut për të organizuar Kryqëzatën dhe për ta çliruar Ballkanin nga sundimi osman. Pjesë e këtij bashkëpunimi ishte edhe mbledhja, transkriptimi dhe studimi i burimeve të shumta, përfshirë dorëshkrimet dhe burimet arkivore ende të papublikuara.



Ai mblodhi, transkriptoi dhe botoi vëllimin "Acta Albaniae Vaticana. Në këtë vepër janë përfshirë 563 dokumente dhe letra papale, që lidhen me Arbërinë, që shumica prej tyre i referohen Gjergj Kastriotit.

Në veprën "Mbi origjinën e kulturës siculo-shqiptare, botuar në Palermo në vitin 1973, Parrino trajtoi origjinën e kulturës shqiptare në Sicili dhe të greko-shqiptarëve që jetojnë në këtë rajon të Italisë. Parrino ofron një studim të hollësishëm të ndikimeve bizantine dhe shqiptare në kulturën e këtij rajoni dhe kontribuon në

pasurimin e njohurive për diasporën shqiptare.

Prof. Parrino ka dhënë një kontribut të rëndësishëm edhe në fushën e gjuhësisë historike, duke studiuar zhvillimin e gjuhës shqipe dhe ndryshimet e saj në bashkësitë arbëreshë në Itali.

Prof. Injac Parrino ka kontribuar edhe në studimin e letërsisë kombëtare në përgjithësi. Ai është përqendruar veçanërisht në veprën monumentale të Gjergj Fishtës, "Lahuta e Malcís", duke kryer përkthimin e plotë të kësaj vepre dhe ka ofruar komente kritike, që ruajnë integritetin e

historia dhe letërsia janë të pandashme.

Në tërësi, trashëgimia shkencore e Prof. Emeritus Ignazio Parrino vijon të shërbejë si një pikë reference për studimet dhe hulumtimet e sotme dhe ato që do të ndërmerren në të ardhmen.

Në fund të konferencës u dhanë disa tituj nderi:

Fondacioni Ndërkombëtar "Papa Klementi XI-Albani-Akademia e Shkencave Historike" dekoroi Prof. Emeritus Ignazio Parrino (pas vdekjes) për merita të veçanta në kërkimin shkencor në Albanologji. Ky Fondacion dekoroi edhe vajzën e tij, Dr. Iliria Parrino dhe kryetarin e Komunës arbëreshë të Palazzo Adriano-s Dr. Nikola Granà. Dekoratat u dhanë nga Prof. Dr. Neritan Ceka, Akademik dhe Prof. As. Dr. Evalda Paci.

Kryetari i Shoqata Atdhetare-Kulturore "Dukagjini", Kolonel Ndue Sanaj dha titullin "Mirënjohja Martin Camaj" Prof. Ignazio Parrinos (pas vdekjes).

Kryetari i Akademisë "Mirdita", Pjetër Marku dha titullin "Yjet e Arberit" Prof. Ignazio Parrinos.

Prof. Msc. Murat Ajvazi, kryetar i Lidhjes së Historianëve në Botë me seli në Zvicër i akordoi Prof. Ignazio Parrinos titullin "Misionar i kulturës arbëreshë".

Kryetari i Shoqatës Mbarëkombëtare "Bytyçi" Tiranë-Prizren, Agron Isa Gjeddia e nderoi albanologun e shquar Ignazio Parrino, me titullin "Nderi i Shqiptarisë".

Konferenca përkujtimore përfundoi me një koktej.

Pas veprimtarisë arbëreshët, të shoqëruar nga Mark Palnikaj u nisën drejt Prishtinës për të marrë pjesë në festimet e 18 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ku u takuan me personalitete të rëndësishëm të jetës politike, shkencore dhe kulturore.

DEDE ZHIVANI



# Lin Delija, arti si ndërgjegje dhe fat njerëzor



**TONIN GJURAJ**  
Rektori i Universitetit  
"Luigj Gurakuqi" të Shkodrës

Figura e artistit shkodran në kryqëzimin e etikës, estetikës dhe kujtesës kulturore, një model orientimi për universitetin dhe shoqërinë shqiptare...

Sot, në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", jemi mbledhur për të rikthyer në vetëdijen tonë kulturore një figurë që tejkalon përmasat e historisë së artit: Lin Delija — si fat njerëzor, si ndërgjegje morale, si simbol kulture dhe si model etik dhe estetik njëkohësisht.

I lindur në Shkodër, në një qytet me traditë të pasur shpirtërore, kulturore dhe intelektuale, Lin Delija u formua në një mjedis ku arti, feja, humanizmi dhe dija bashkëjetonin natyrshëm. Rruga e jetës së tij u ndërta mbi përvojën e mërgimit, të ndarjes dhe të vetmisë, duke e shndërruar krijimtarinë e tij në dëshmi të thellë njerëzore dhe në shprehje të një etike të përjetuar.

Arratisja nga diktatura, jeta në mërgim, ndarja nga atdheu dhe përvoja familjare të dhimbjes u bënë burime të brendshme të një piktore me densitet moral, me thellësi shpirtërore dhe me dinjitet njerëzor. Prej tyre u formua një art me qetësi të brendshme, me përmbajtje, me disiplinë shpirtërore dhe me një gjuhë simbolike të përqendruar.

Në veprën e Lin Delijës, figura njerëzore shfaqet si qenie ekzistenciale; hapësira merr formën e një gjendjeje shpirtërore;

Salla "Walter Höflechner"  
Biblioteka e Universitetit  
"Luigj Gurakuqi" - Shkodër

2 shkurt 2026  
ora 11.00

**LIN DELIJA** **Arti konkret**  
**shpirtit**

**Konferencë shkencore**

Përsëndet Prof. dr. Tonin Gjura  
Rektor i Universitetit "Luigj Gurakuqi"

Referojnë:  
**Ardian Ndreca, Sidi Kanani, Zef Paci, Lekë Gjeloshi**

ngjyra shndërrohet në gjuhë etike. Ai pikturon kuptimin, ndërton përvojën e brendshme dhe shpreh pasojat e realitetit mbi shpirtin njerëzor.

Për këtë arsye, Lin Delija përfaqëson një figurë të kohës moderne: artist i njeriut të zhvendosur, i identitetit në kërkim të vetes, i vetmisë urbane, i nevojës për

kuptim dhe për orientim shpirtëror në një botë me ritme të shpejta dhe transformime të thella.

Këtu, në Shkodër — qytet i kujtesës historike, i trashëgimisë kulturore dhe i rezistencës shpirtërore — figura e Lin Delijës merr një domethënie të veçantë. Ai përfaqëson bijtë e këtij qyteti që u larguan

fizikisht, por e ruajtën Shkodrën si kod kulturor, si strukturë etike dhe si kujtesë identitare, për të frymuar në dinamikën e ngjyrës energjinë dëshmuar të dhimbjes jetësore të saj.

Në këtë kontekst, aktivitetet e zhvilluara vitet e fundit në Shqipëri për figurën e tij — ekspozitat në Shkodër dhe Tiranë, rikthimi i veprave të tij për publikun shqiptar, përpjekjet për krijimin e një muzeu dhe iniciativat institucionale për promovimin e trashëgimisë së tij — përfaqësojnë akte të rëndësishme ripërvetësimi kulturor dhe ndërtimi të kujtesës kolektive, një kthim dhe njohje e vetes dhe një afrim me frymën e artistit Delija. (Universiteti i Shkodrës, së shpejti, do të botojë një monografi për Lin Delijën, me kontributin e pedagogut Sidi Kanani.)

Për Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", kjo konferencë përfaqëson një moment të rëndësishëm vetëdijeje institucionale. Universiteti sot përballet me sfida shkencore, kulturore dhe shoqërore, që kërkojnë përgjigje të reja, vizion afatgjatë dhe orientim etik. Në këtë realitet, universiteti afirmon rolin e tij si hapësirë e dijes, e kulturës, e formimit njerëzor dhe e përgjegjësisë shoqërore.

Në këtë kontekst, figura e Lin Delijës shërben si model i një arti që ndërton vlera, që ushqen vetëdijen kulturore dhe që forcon përgjegjësinë shoqërore. Ai përfaqëson artistin si ndërgjegje, krijuesin si figurë morale dhe artin si mision kulturor.

Shoqëria shqiptare sot përjeton transformime të thella identitare dhe kulturore, që kërkojnë modele referenciale të qëndrueshme. Në këtë realitet, vepra dhe figura e Lin Delijës ofrojnë një orientim të qartë: një art që forcon dinjitetin njerëzor, një kulturë që ndërton vetëdije dhe një universitet që edukon qytetari.

Prandaj kjo konferencë përfaqëson një hapësirë reflektimi kolektiv, një moment vetëdijeje kulturore, një proces ndërtimi identitar dhe një akt përgjegjësie institucionale.

Sepse "arti konkret i shpirtit" shndërrohet në një orientim për kohën tonë dhe në një horizont vlerash për të ardhmen.

Le të shërbejë kjo konferencë si burim frymëzimi, si platformë dialogu dhe si nxitje për ndërtimin e një kulture universitare që bashkon dijen, artin dhe etikën.

Faleminderit!

## Shpirti i pikturës së Lin Delijës dhe kampusi i Universitetit 'Luigj Gurakuqi'.

Nga Qamil GJYREZI

Me datë 2. Shkurt. 2026 u zhvillua në sallën 'Walter Hoflechner', të Bibliotekës së Universitetit 'Luigj Gurakuqi', konferenca shkencore me temë: 'Lin Delija, Arti konkret i shpirtit'. Konferencën e përshëndeti Prof. dr. Tonin Gjura, Rektor i Universitetit Luigj Gurakuqi Shkodër. Në konferencë referuan Profesor Ardian Ndreca, Sidi Kanani, Zef Paci dhe Lekë Gjeloshi. Në fjalën e tij, rektori Gjura u

ndal te roli i universitetit si hapësirë e dijes, e kulturës dhe e përgjegjësisë shoqërore, duke nënvizuar se për UNISHK kjo konferencë përfaqëson një moment të rëndësishëm vetëdijeje institucionale. Në një realitet të shënuar nga sfida shkencore, kulturore dhe shoqërore, universiteti, duhet të ofrojë përgjigje të reja, vizion afatgjatë dhe orientim etik, duke afirmuar misionin e tij si institucion formues jo vetëm profesional, por edhe njerëzor.

Konferenca iu kushtua figurës së Lin

Delijës, një nga individualitetet më të spikatura të pikturës shqiptare të shekullit XX, artist që ka ditur të ndërthurë temat kombëtare me universalen, duke ndërtuar një gjuhë artistike autentike dhe thellësisht shpirtërore. Konferenca është aktivitet në vazhden e promovimit të Universitetit 'Luigj Gurakuqi', drej kërkimit shkencor dhe inovacionit dhe e promovimit të figurave shkencore dhe artistike të lidhura me Shkodrën, Shqipërinë dhe arrijet evropiane.

Referatet ishin me nivel shkencor, artistik dhe prezantuan punët e piktorit Lin Delija, që përfaqëson një simbol të artit italo-shqiptar. Institucionet e artit në Shqipëri dhe Kosovë, studiuesit e artit duhet të studiojnë shkencërisht dhe të promovojnë kontributin artistik të piktorit Lin Delija. Piktura e Lin Delijës duhet të ketë një vend të shquar në Galerinë Kombëtare të arteve në Tiranë. Kontributi artistik dhe intelektual i piktorit Lin Delija duhet të jetë objekt i studimit të fakultetit të shkencave shoqërore, të edukimit, degës së artit, të Universitetit 'Luigj Gurakuqi'.

Prof. Ardian Ndreca si studiues, publicist dhe përkthyes shqiptar, profesor i filozofisë moderne në Universitetin Urbaniana në Romë duhet të jetë pjesë e rëndësishme e këtij promovimi filozofik-estetik në Universitetin 'Luigj Gurakuqi'.

(vijon në faqen 5)

# Një hap i rëndësishëm drejt një shkolle më e gjithëpërfshirëse

PROMOVOHET MONOGRAFIA “MENAXHIMI I KLASËS NË SHKOLLIMIN GJITHËPËRFSHIRËS” NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”

Të jesh pjesë e një promovimi libri që trajton shkollimin gjithëpërfshirës nuk është thjesht një përvojë akademike, por edhe një moment reflektimi profesional dhe njerëzor.

Më 9 shkurt, pata kënaqësinë të jem e pranishme në ambientet e Bibliotekës Shkencore të Universiteti “Luigj Gurakuqi”, ku u zhvillua promovimi i monografisë “Menaxhimi i Klasës në Arsimin Gjithëpërfshirës”, një botim me vlerë të veçantë për fushën e pedagogjisë speciale dhe shkollimit gjithëpërfshirës në Shqipëri.

Autoret, Dr. Arlinda Hallunovi Ymeri, Doktoreshkencash në Psikologji dhe zv. Dekane në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, si dhe MSc. Erudita Fshazi, psikologe dhe pedagoge e jashtme, sollën përpara bashkësisë akademik, arsimor dhe profesional një vepër që ndërthur thellësinë teorike me orientime konkrete për praktikën në klasë. Që në momentet e para, u ndje se ky aktivitet nuk ishte thjesht një prezantim libri, por një hapësirë dialogu mbi sfidat reale të menaxhimit të klasës në kushtet e diversitetit.

Veprimtaria mblodhi akademikë, përfaqësues të institucioneve shkollore, profesionistë të shëndetit mendor, mësues, studentë dhe të rinj të angazhuar, duke u shndërruar në një forum reflektimi mbi sfidat dhe mundësitë e ndërtimit të një shkolle që përfaqon diversitetin si vlerë.

Në fjalën e hapjes, Rektori i Universitetit, Prof. Dr. Tonin Gjuraj, e cilësoi monografinë si një kontribut të rëndësishëm në trajtimin e neurodiversitetit si paradigmë e re mendimi në shkollimin special. Ai theksoi se libri zhvendos fokusin nga qasja tradicionale e bazuar në deficit drejt një vizioni që e konsideron diversitetin neurologjik si burim zhvillimi, potenciali dhe inovacioni pedagogjik. Sipas tij, kjo qasje është thelbësore për formimin e mësuesve të rinj dhe për përmirësimin e praktikave shkollore në përputhje me standardet bashkëkohore ndërkombëtare.

Në vijim, zj. Brisela Kadia, Drejtuese e Zyrës Vendore të Shkollimit, ndau përvojën e terrenit, duke theksuar sfidat reale të menaxhimit të klasave gjithëpërfshirëse: shtimin e mësuesve ndihmës, nevojën për trajnim të vijueshmërinë të mësuesve dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional. Ajo nënvizoi se literatura e specializuar në gjuhën shqipe është një mbështetje e çmuar për praktikën e përditshme.

Prof. Dr. Fatmir Vadohej analizoi strukturën dhe përmbajtjen shkencore të veprës, duke e cilësuar atë si një tekst të ndërtuar me rigorozitet akademik dhe të mbështetur në rreth 200 burime bashkëkohore dhe klasike. Ai vlerësoi veçanërisht faktin që monografia plotëson një boshllëk në literaturën pedagogjike shqiptare, duke ofruar një trajtim të integruar të neurodiversitetit, rolit të mësuesit ndihmës dhe sfidave sistematike të shkollimit gjithëpërfshirës në vend.

Nga këndvështrimi universitar, pedagogjia Megi Vjerdha - Shllaku u ndal në lidhjen organike mes teorisë dhe praktikës, duke theksuar se libri ofron modele konkrete të menaxhimit të klasës dhe orientime të zbatueshme në realitetin shkollor shqiptar.

Një kontribut i veçantë në diskutim erdhi nga neuro-psikiatristja për fëmijë dhe adoleshentë, Dr. Kledi Bala - Lame, e cila solli perspektivën e shëndetit mendor.

hmës dhe sfidave sistematike të shkollimit gjithëpërfshirës në vend.

Dr. Arlinda Hallunovi Ymeri ka përfunduar studimet e larta në programin Bachelor në Psikologji në vitin 2008, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Ajo ka përfunduar studimet Master Shkencor në Psikologji Shkollore dhe Organizative në Universitetin e Shkencave Sociale në Tiranë në vitin 2010, ku në vitin 2011 ka marrë edhe gradën Doktor në Shkencave në Psikologji. Ajo është lektore që prej vitit 2011 në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit. Dr. Arlinda Hallunovi Ymeri është psikologe me mbi 10 vite përvojë në sistemin e shëndetësisë, ku ka qenë e angazhuar në vlerësim dhe ndërhyrje psikologjike. Që nga viti 2008 ka pasur si eksperte psikologe në sistemin e drejtësisë, duke kontribuar në vlerësimet profesionale për çështje gjyqësore. Ajo zotëron ekspertizë në trajtimin e traumës, veçanërisht pas tërmetit të vitit 2019 në Shqipëri. Profili i saj profesional karakterizohet nga përvojë e konsoliduar ndërinstitucionale. Aktualisht, ajo ushtron detyrën e Zëvendësdekanit në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universitetin “Luigj Gurakuqi”.

Erudita Fshazi është psikologe klinike, e zhvillimi dhe marrëdhënies, me mbi 13 vite përvojë në fushën e psikologjisë. Ajo është psikoterapistë e certifikuar BWRT niveli 1 & 2 dhe teknike e regjistruar e sjelljes (RBT). Si themeluese dhe administratore e qendrës “Wellbeing”, ajo ofron shërbime psikologjike, vlerësimet zhvillimore dhe terapi bashkëkohore për fëmijë, të rinj dhe të rritur. Përveç praktikës klinike, zj. Fshazi është pedagoge e jashtme në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, ku angazhohet në formimin akademik dhe praktik të studentëve, duke përfshirë qasje moderne terapeutike dhe përvojë profesionale të drejtëpërditshme. Në punën e saj ajo ndërthur qasjen shkencore me ndjeshmërinë njerëzore, duke përdorur ndërhyrje të bazuara në evidencë për zhvillimin emocional, social dhe sjellje të individëve. Eksperienca e saj përfshin bashkëpunime me gjykatat dhe institucione ligjore, organizata jofitimprurëse, shkolla publike e private, si dhe sektorë të ndryshëm të shërbimeve mjekësore, në mbështetje të mirëqenies psikologjike dhe sociale të individëve. Ajo ka qenë folëse në Kongresin e 8-të Botëror të BWRT në Londër dhe është përfaqësuare si delegatë në HESA Fellowship në Oksford, ku ka përfaqësuar Shqipërinë në fushën e zhvillimit profesional dhe lidhësipit në shëndetin mendor.

Ajo theksoi rëndësinë e identifikimit të hershëm të çrregullimeve neurozhvillimore dhe të ndërhyrjes së koordinuar mes shkolles, familjes dhe profesionistëve klinikë, duke e konsideruar klasën si një hapësirë ku ndërthuren edukimi dhe mirëqenia psikologjike.

Në dimensionin praktik, zj. Anisa Kapidanja prezantoi raste konkrete nga terreni, duke reflektuar mbi sfidat e zbatimit të Planit Individual të Edukimit dhe mbi nevojën për praktika profesionale të strukturuar në këtë fushë.

Ndërsa Admir Dahati, koordinatori i Klubit Studentor OBSERV, përfaqësoi zërin e studentëve, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së studentëve përgjatë përgatitjes akademike të bazuar në realite-

tin e klasës dhe në kërkesat e shkollimit bashkëkohor.

Një moment veçanërisht prekës i vepërimitarisë ishte ndërhyrja e Enea Ymeri, djalit të autores së parë, i cili me emocion ndau me të pranishmit përkushtimin e palodhur që kishte parë tek nëna e vet gjatë procesit të hartimit të librit. Ai foli për orët e gjata të punës, për sakrificat e heshtura dhe për pasionin që e kishte shoqëruar këtë rrugëtim akademik. Fjalët e tij sollën një dimension thellësisht njerëzor në këtë ngjarje shkencore, duke rikujtuar se

shumëdimensional i mësuesit ndihmës.

Kapitulli II – Dizajni Universal për të Nxënë (UDL) dhe teknologjitë ndihmëse, që ofron një kornizë të qartë mbi fleksibilitetin didaktik, mësimin multisensor dhe përdorimin e teknologjisë për të garantuar akses dhe pjesëmarrje.

Kapitulli III – Organizimi i mësimit dhe menaxhimi efektiv i klasës, i fokusuar në planifikimin, menaxhimin e kohës dhe ndërtimin e një mjedisi të strukturuar e mbështetës.

Kapitulli IV – Disiplina, mësimi i programuar dhe qasjet digjitale, që analizon qasjet tradicionale dhe bashkëkohore, përfshirë dimensionin e e-learning.

Kapitulli V – Dokumentacioni profesional dhe sfidat e mësuesit në kontekstin shqiptar, ku trajtohen PIE (Plani Individual i Edukimit), raportet periodike dhe bashkëpunimi me prindërit, në krahasim me modele ndërkombëtare.


Në përmbyllje të aktivitetit, zj. Arlinda Ymeri u ndal veçanërisht tek falënderimet e sinqerta për të gjithë bashkëpunëtorët, kolegët, institucionet dhe mbështetësit që kontribuan në realizimin e këtij botimi. Ajo theksoi se një vepër e tillë nuk është rezultat i një pune individuale, por i një procesi të përbashkët profesional dhe njerëzor. Së bashku me zj. Erudita Fshazi, autoret ndanë vizionin e tyre për menaxhimin e klasës si një proces kompleks që kërkon kompetencë profesionale, ndjeshmëri njerëzore dhe bashkëpunim të vazhdueshëm mes akademisë, shkollës dhe komunitetit. Ato nënvizuan se arsimit gjithëpërfshirës nuk është një alternativë apo zgjedhje dytësore, por një domosdoshmëri etike dhe shoqërore për çdo sistem arsimor që synon barazi dhe cilësi.

Promovimi i kësaj monografie nuk përfaqëson vetëm prezantimin e një libri të ri në tregun akademik dhe profesional shqiptar. Ai shënon një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të një kulture shkollore, që e sheh diversitetin si pasuri dhe klasën si një hapësirë zhvillimi për të gjithë. Në një kohë kur sfidat e sistemit arsimor kërkojnë përgjigje të mirëstrukturuara, të informuara shkencërisht dhe të ndjeshme ndaj realitetit, kjo vepër vjen si një kontribut i vyer në shërbim të një shkolle më të drejtë, më profesionale dhe më njerëzore.

Monografia “Menaxhimi i Klasës në Arsimin Gjithëpërfshirës” përfaqëson jo vetëm një arritje akademike, por edhe një vlerë të shtuar për bibliotekën e çdo mësuesi, studenti të shkencave të edukimit, drejtuesi shkolle dhe profesionisti që beson në fuqinë transformuese të arsimit. Ajo është një ftesë për reflektim, përmirësim dhe angazhim të përbashkët në ndërtimin e një shkolle që i përket të gjithëve.

Përgatitur nga:

Suela Ndoja, PhD (c),  
anëtare e Kryesisë së SHAD





# Rozafa dhe Shirgji, miti vendas nga historia e largët!

Mesa duket shumë nuk e dinë, se emrat e Rosaphat dhe Sergi, që ne e shqiptojmë Shirgji / Kisha e Shirgjit, erdhi nga legjionarët vendas, që shërbenin në lindje të perandorisë romake.



nga Ali Laçaj

Emrat lidhen shpesh me Rosafa (e shkruar edhe Resapha ose Rusafa), qytetin e shkretëtirës në Sirinë e sotme, ku u martirizua Sergiusi dhe që më vonë u riemërua Sergiopolis, për nder të tij. Sergius dhe Bacchus janë shenjtorët më të "çiftuar". Në hagiografinë e tyre, ata ishin komandantë romakë dhe "vëllezër armësh" që refuzuan t'i bënin fli Jupiterit. Bacchus vdiq i pari nën tortura dhe shpirti i tij thuhet se iu shfaq Sergiusit, për ta inkurajuar atë të duronte ekzekutimin e tij të fundit në Rosapha.

Në studimet moderne, marrëdhënia e tyre shpesh përmendet në diskutimet rreth adelphopoiesis (një rit "vëllazërimi"), gjë që i ka çuar ata të bëhen ikona të rëndësishme në kontekste të ndryshme historike dhe kulturore.

**Kisha e Shirgjit:** E vendosur pranë Shkodrës, kjo rrënoje e shekullit të XIII ishte fillimisht Abacia e Shën Sergjit dhe Shën Bakut (Kisha e Shën Shirgjit dhe Bakut). Për shekuj me radhë, ishte një vend i rëndësishëm pelegrinazhi si për katolikët ashtu edhe për të krishterët ortodoksë. Të tilla u ngritën në Himarë dhe Prizren. Në Konstandinopojë (Stambolli i sotëm) u ngrit Kisha e Shën Sergjit dhe Bakut, e ndërtuar nga perandori Justinian I, në shekullin VI. (Kjo kishë njihet si "Shën Sofia e Vogël", për shkak të stilit të saj arkitekturor me kupolë, sot njihet si Küçük Ayasofya Camii) dhe duke qenë se martirizimi i tyre ndodhi në Siri, kjo zonë mbeti vatra kryesore e kultit:

- Rosafa (Sergiopolis): Ky qytet në Siri u riemërua për nder të Shën Sergjit dhe u bë një nga qendrat më të mëdha të pelegrinazhit në botën e krishterë lindore.

- Maaloula: Një manastir i famshëm i dedikuar atyre ekziston ende në këtë fshat sirian, ku flitet ende gjuha aramaikë (gjuha e Jezusit).

Në Romë: Ekziston kisha Santi Sergio e Bacco pranë Forumit Romak, e cila daton që nga shekulli IX dhe shërben si kishë kombëtare për bashkësinë Ukrainas Katolike të Rritit Bizantin.

Në Kajro (Egjypt): Kisha e Shën Sergjit dhe Bakut (Abu Serga) në Kairon e Vjetër është një nga kishat më të vjetra Kopte, e ndërtuar mbi vendin ku besohet se u strehua Familja e Shenjtë gjatë arratisjes në Egjipt. Pse ishin kaq të përhapura? Ata konsideroheshin shenjtorë ushtarakë. Për këtë arsye, kishat e tyre gjendeshin shpesh pranë kështjellave, rrugëve kryesore (si Via Egnatia) ose porteve, pasi ushtarët

dhe tregtarët kërkonin mbrojtjen e tyre gjatë udhëtimeve të rrezikshme.

Kulti i Shën Sergit dhe Bakut ishte një kult që u ba i modës dhe mesa duket frymëzonte ushtaraket me shembullin heroik, prandaj ka disa kisha dedikuar atyre te dyve... (Shembull përsëritës: Kulti i Shën Gjon Vladimirit të Krajës...e cila daton para ndarjes së kishave lindore e perëndimore, natyrisht para Islamit, e që ma vonë KPS-Kisha Pravosllave Serbe mundohet ta pronësoje / dikur festa e Shën Gjon Vladimirit dhe procesioni në Rumije ndërmerrej nga te tre religjionet e pranishme në Kraje, gjë që flet për rrajat...).

Kështjella e Shkodrës - Rozafat: Ekziston një lidhje e thellë gjuhësore dhe historike midis emrit Rozafa (kështjella e famshme në Shkodër) dhe Rosapha (qyteti i Sergjit në Siri).

Shumë historianë besojnë se emri u soll në Shqipëri nga të krishterët. Në rrajat e veta ky vend, asnjëherë në histori, nuk thirret Rozafat, por Skodrinon / Shkodër/ Scutari / Uskydar, që janë të gjitha transkripte ILIRO-SHQIPTARE, ku dy të fundit janë deformime Veneciane dhe Osmane të emrit origjinal SCODRINON. Emri Rozafa nuk përmendet asnjëherë në asnjë burim dhe në asnjë rast tjetër as nga popullsia vendase e as nga burimet historike, përveçse në Legjendën e saj.

Lidhja Persiane: Khosrau II dhe "Shenjtori i Lindjes". Ndërsa legjenda shqiptare bazohet në folklor, historia në Iran (Persi) është dokumentuar në kronikat mbretërore. Është e rrallë që një Mbret jo i krishterë të favorizojë një shenjtor të krishterë kaq publikisht.

Betimi: Kur Mbreti Sasanid Khosrau II po i ikte një uzurpatori, ai iu lut Shën Sergjit të Rosafa-s për mbrojtje. Kur ai rimori fronin e tij, në vitin 591 pas Krishtit, ai ia atribuoi Shenjtit.

Kryqi i Artë: Ai dërgoi një kryq të madh prej ari të zbukuruar me gurë të çmuar në faltoren në Rosafa (Siri). Mbishkrimi në kryq (i shkruar në greqisht) falënderonte "Sergjin e Shenjtë dhe Fitimtar" për ndihmën që i dha gruas së tij, Mbretëreshës Shirin, të ngjizte një djalë. (Në periudhën e Perandorisë Bizantine, gjuha e administratës dhe liturgjisë ishte Greqishtja e Bizantit). Në foto: Rosafa (Sergiopolis), qyteti antik në shkretëtirën e Sirisë, ku u martirizua Shën Sergji Ura Kulturore: Kjo krijoi një "kult të Sergjit" brenda Mbretërisë Persiane, ku ai shihej jo vetëm si një shenjtor romak, por si një mbrojtës i shtëpisë mbretërore Persiane.

**Si u zhvendos "Rosapha" nga Siria në Shkodër?**

Historianët besojnë se emri udhëtoi

nëpërmjet rrugëve ushtarake dhe tregtare BIZANTINE: Siria: Rosapha bëhet një vend masiv pelegrinazhi (Sergiopolis).

Bizanti: Kulti i ushtarit-shenjtor Sergius përhapet në Ballkan. Shqipëria: Emri "Rosapha" i është aplikuar kodrës dominuese në Shkodër. Me kalimin e kohës, emri i qytetit të origjinës së kultit të Shën Sergjit / Shën Shirgjit, (Rosapha) dhe emri i gruas në mur (Rozafa) u bashkuan në legjendën që kemi sot.

Vete Legjenda e Rozafës, mesa duket me origjinalja nga të gjitha motërzimet, i gjen të njëjtat motive gjithandej në mitin e muosjes.

Legjenda e Rozafës: Legjenda tregon për tre vëllezër që punuan pa u lodhur për të ndërtuar një fortesë në një kodër. Megjithatë, ata u përballën me një problem misterioz: Çdo gjë që ndërtuan gjatë ditës do të shkrëmoqej dhe do të shembej gjatë natës.

Këshilla e Njeriut të Mençur: Një plak i mençur (ose ndonjëherë një zanë (vilë mali) u tha vëllezërve se muret do të qëndronin vetëm nëse bënin një sakrificë. Ata u udhëzuan të varrosnin të gjallë cilëndo nga gratë e tyre që do t'u sillte drekë të nesërmen.

Ka dy versione që lidhen me qëndrimin e vëllezërve. Mua më pëlqen versioni i Besës!

1. Besa: Vëllezërit e bëjnë me fjale dhe nuk u thonë asgjë grave. Motra / nuse e vogla, që kish një fëmijë për gjini nuk e lëshon radhën me shkua me buke te burrat, sepse e madhja ishte e sëmurë dhe e dyta ishte me barre. Ajo e mban fjalën.

2. Tradhtia: Vëllezërit u betuan (një besa), që të mos u tregonin grave të tyre për paktin, duke ia lënë zgjedhjen fatit. Megjithatë, dy vëllezërit më të mëdhenj e thyen fjalën dhe i paralajmëruan gratë e tyre të qëndronin larg. Vetëm vëllai më i

vogël mbeti i ndershëm dhe nuk tha asgjë.

Sakrifica: Të nesërmen, gruaja e vëllait më të vogël, Rozafa, mbërriti në vend me ushqim. Pavarësisht hidhërimit të vëllait më të vogël, sakrifica vijoi. Kërkesa e Nënës: Rozafa e pranoi fatin e saj, por bëri një kërkesë zemërthyesë për hir të djalit të saj të mitur. Ajo kërkoi që ta linin syrin e saj të djathtë të ekspozuar për ta parë, dorën e djathtë për ta përkëdhelur, këmbën e djathtë për ta tundur djepin e tij dhe gjoksin e djathtë për ta ushqyer.

Versioni i treguar nga Eruditi Sami Dani - poliglot, i cili e mbylli jetën në Azilin e Pleqve; version i marre me shënime dore nga z. Vaid Coku; krijon një narrative tjetër, ku në përmbyllje të këngës së kënduar nga lahutari Rashid. (Sami Dani e ka takuar Rashidin Sanxhakli në Smirna / Izmiri i Sotëm).

"Në 1934 e kam taku Rashidin për her t'parë, tek i binte lahutës, tuj këndu kangt për Skënderbeun, Mujin etj. Kishte një zà t'fort edhe pse ishte gati 80 vjeç. Kur e kam ndigju tuj këndu me lahutë historinë e kalasë Rozafa, s'kisha kja kurrë deri at'her, por aty kam kja me lot tuj e ndigju me lahutë Rashidin, dhe t'tan shqiptaret e tjerë që e ndigjojin, ishin tuj kja njisoj si un." Legjenda, simbas Lahutarit Rashid mbyllet kështu: Lot' e Fà-s qi pat pikë me pika t'tamllit t' Rozës bashkë një krù t' bardh e kan formë n'mur t'kalës rriin tuj pikë ndamàr e rrëma t'bardh ngurtùe Për çdo nàn qi s'po ka gjí foshnje t'vet m'i dhàn me pí njat rrëm t'bardh n'uj me e shkri e njàja nàn qi ka më pí nj'atij fmí qi t'i jep gjí ka me rrit nder, bes e burri Kshtë e mùr emnin kjo kalà prej dy motrash Roza-Fà t'flijueme n'mure t'saja qi përjet me rrnùe kalaja "Qumështi" i Kalasë: Nëse vizitoni Kalanë e Rozafës sot, do të vini re ujë të bardhë, të pasur me gëlqere që pikon nga gurët. Folklori vendas thotë se ky është "qumështi i Rozafës" që ende rrjedh nga muret për të siguruar për fëmijën e saj. Variacione dhe Simbolizëm Në hapësirën shqiptare kemi 24 variante të Baladës së Flijimit nga Kraja në Veri, në Margëlliç të Çamërisë deri në Shalën e Bajgores.

Ndërsa VERSIONI SHQIP është ndoshta më i famshmi, historia ekziston në disa kultura në të gjithë rajonin: **Serbi:** Poema epike Ndërtimi i Shkodrës (Zidanje Skadra) tregon të njëjtën histori në lidhje me vëllezërit fisnikë Mrnjavčević. Lahutarët Kelmendas te emigruar ne rajonet Serbe, si duket kane marre me vete



Në foto: Rosafa (Sergiopolis), qyteti antik në shkretëtirën e Sirisë, ku u martirizua Shën Sergji

# E DIELA E FUNDIT E BUZËQESHJES

(NJË ESE ELEGJIAKE PËR MOTËR MANDALENËN)

Ike në mes motit me shi, që s'po ndalë në këtë dimën. Ike të dielën, kur qielli randonte plumb prej reve të denduna, të mbarsuna me stuhi. U nise drejt Italisë me një peshë rëndë mbi supe që as çetinat e bjeshkës s'do ta mbanin dot. Ishte një sëmundje tumorale e kamuflueme, që nuk t'u nda kurrë: herë hapët, herë e maskue-me, për katër vjet e gjysmë rresht.

Në këtë luftë të pamëshirshme u tregove luftëtare e vërtetë. Që prej ditës kur ta thanë troç në Itali e deri në fund, asnjëherë nuk u nënshtruve, nuk u nervozove, nuk u ankove. S'të pa kush as tue qa, as tue mallkue fatin e zi që të zuni pritë në moshën 40-vjeçare e që nuk t'u nda për gati pesë vjet.

Sa herë që të pyesnim, plot ankth:

— Mandalenë, si je?

ti, me butësi e pa t'u tretë buzëqeshja, përgjigjeshe:

— Mirë jam.

Edhe kur ishte shumë keq, edhe kur ishte shumë randë, prapë thoshe: mirë jam.

Jo veç si vëlla, por edhe si poet, kjo forcë karakteri më bani thellë përshtypje. Në situata të tilla, njerëz që duken të fortë si shkëmbi, përkulen, thyhen, humbin kontrollin. Ndërsa ti, Mandalenë, mbete gjithnjë e butë si bleta: delikate, e qeshun, gojë-mjaltë si gjithmonë. Kurrë nuk fole keq për askënd, as në shtëpi, as në shoqni, as kund.

Edhe të dielën e fundit, kur u largove prej shtëpisë, s'ta pa kush trishtimin në sy. Edhe atë të dielë, kur u nise prej Shqipnisë, përmes aeroportit "Nënë Tereza" që doli me qenë e fundit e diel e jetës sate



buzëqeshja nuk t'u fshi, ndonëse e dije se një gjarpënushë e pamëshirshme të kishte pickue trunin e të kishte turbullue shikimin.

Na u duk të gjithëve se do ta kaloje edhe këtë herë. Shkove prapë në atë shtëpi ku shërohen e zbuten plagët e jetës; aty ku u operove një herë e bane terapi të gjata, intensive. Ajo shtëpi shëndeti, krahasue me tonat, ishte vite-dritë larg. Këtë radhë mjeket që për kurën tënde harxhuan qindra mijra evro, pa pyetur, as nga vjen, a je milionere apo shtrese punëtoze siç ishte ti,

u dorëzuan. E fundit që u dorëzove ishte ti Madolenë. Lufta finale zgjati prej të hënës deri të premtën. Veç gjysmë dite qe agonia jote para se të kaloje në amshim. Na tron-dite, na lëndove dhe na varfënove.

Duart po më dridhen e loti po më pikon teksa shkruaj; mendimet po më ngatërrohen. M'u kujtue elegjia e famshme e Çajupit. Mandalenë, ti nuk ike si e pabesë. Ikja jote ishte e paralajmërueme. Ike si një shenjtoze e vogël. Ike por s'duhej te ikje.

Si ike bre ashtu, tue lanë mbrapa Stelën, Sarën, Gentjanën, Gretën si lule të njoma, secila ma e bukur se tjetra. A e dije apo s'e dije se për to ishte perëndeshë e mirësisë dhe dashurie? Dashunia jote ishte pashunia ma e madhe që kishin. Si ua more bre këtë dhuratë, që s'ka me ua zëvendësue, asnjë mreku!

Kur u nise për atë udhë pa kthim, a mendove se kush ka me e qetësue Gretën e vogël, që tash asht në klasë të dytë? Veç ti ke qenë qetësimi dhe dora e saj e bekueme. Ti e dite mirë se ajo të ndoqi hap pas hapi deri në Itali. Kur ajo të thërret: nanë, ku je? — kush ka me i përgjigjë?

Thonë se motra Terezinë të paska marrë pranë vetes. Ndoshta. se ajo kishte mbet pa ty qysh prej asaj dite kur gremina e shkëmbit të Mehil Nikës e përpui. Ti ishte aty, e tmerrueme, tue pa gjithçka. Po sot pse deshe me shkue mbrapa saj? Zina ka me u gëzue fort për ty. Babagjyshi Bale si burrë i urtë, ka me të qortue me dashmirësi: pse erdhe adhësh e bardhë. Gjyshe Dada ka me të thanë: moj çikë, a din se kush vjen këtu s'kthehet ma. Nana File ka me të përkëdhelë e me të qortue njëkohësisht: kujt ia le vajzat? Baba Mark,

me dhembshuni, ka me të marre grykë si atëherë kur ishte çupulinë e vogël e ka me te thane:

Mandalenë, s'të prisja kaq shpejt, por tash që erdhe, ma shtjer krahun si dikur e t'i biem pashë më pashë Parajsës.

Erdhe në jetë në mes dimnit me borë, e në mes dimnit me stuhi u largove. U rrite thjeshtë, siç ishte koha atëherë: me harmoni, edukatë, ndjenjë pune e sakrifice. U martove dhe krijove një familje pasqyrë thjeshtësie, ku dashunia, harmonia dhe edukata ishin ma të shtrenjta se buka e fitueme me djersë.

Në këtë kohë turbullinash dramatike, ju dëshmuet se familja asht mbi gjithçka; se mund të jetohet thjeshtë e me lumtuni kur në mes asht dashunia bashkëshortore dhe misioni prindnor.

Shembulli i bashkëshortit tand, Mirash Sukaj, në përkushtim e sakrificë, sidomos në çastet ma dramatike të jetës sate, meriton me u marrë si model shoqnor e si personazhi letërsie. Në këtë botë që flet veç me gjuhën e parasë e interesit, ka ende burra të tillë si Frrok Doçi nipi i bashkëshortit tënd, prej Shale qe me devocion e përkushtim, t'u ba vëlla i dytë.

Ti ike, Mandalenë, por nuk more me vete gjithçka. Na le një mënyrë me e dashtë jetën pa zhurmë, me e përballue dhimbjen pa britmë, e me e ruejtë dinjitetin deri në frymën e fundit. Dhe kjo qe trashëgimia e jotja, e filmi yt u mbyll pa duartrokitje, por me dritë të butë që s'fiket se disa njerëz, edhe kur ikin, vazhdojnë me ecë përpara nesh. E kjo dritë tokësorë ka me ecë përpara në fëmijët, në kujtimet, në heshtjen që flet ma fort se çdo fjalë. Zoti të deshi pranë vetit ndaj të mori .Drita e amshuar po të pret!

PRELE MILANI

edhe kangen dhe emnat qe i kane sllavizuar (Merrnaçajt jane nje familje nga Vilaznia e Selces, të krahinës së Kelmendit)

**Greqi:** Një legjendë e ngjashme ekziston për Urën e Artës, ku ndërtuesi kryesor duhet të sakrifikojë gruan e tij. Murosja Si Fenomen Mitik Universal Kjo legjendë është pjesë e një fenomeni global të njohur si legjenda "Motivi i Murimit" ose "Sakrificica e Themelit". Ndërsa versioni ballkanik i tre vëllezërve është më i plotë nga ana strukturore, "analoge" pothuajse identike ekzistojnë në kultura të ndryshme, shpesh duke ndjekur të njëjtin model: një strukturë që nuk do të qëndrojë në këmbë, një kërkesë mbinatyrore për sakrificë dhe një viktimitë tragjike.

Te ngjashmet më të spikatura nga e gjithë bota:

1. Hitobashira (Shtylla Njerëzore) Japoneze:

Në Japoni, praktika e Hitobashirës përfshinte varrosjen e një personi të gjallë nën themelet e një kështjelle, ure ose dige për të qetësuar shpirtrat e tokës ose të ujit. Kështjella Maruoka: Legjenda thotë se muret e kështjellës vazhdonin të shembeshin gjatë ndërtimit. Një grua me një sy e quajtur O-shizu u sakrifikuua si një "shtyllë njerëzore" me kusht që djali i saj të bëhej samurai. Ura Matsue Ohashi: Legjenda tregon për një burrë të quajtur Gensuke i cili u varros i gjallë nën shtyllën qendrore të urës në shekullin e 17-të sepse rryma e lumit ishte shumë e fortë për t'u përballuar nga ndërtimi.

2. Mjeshtri rumun Manole:

Kjo është përputhja më e afërt strukturore me legjendën shqiptare. Legjenda: Mjeshtri Manole dhe nëntë muratorët e tij po ndërtojnë Manastirin e Curtea de Argeș. Çdo natë, muret shemben. Manole sheh një ëndërr se duhet të sakrifikojë gruan e parë (gruan ose motrën) që u sjell ushqim mëngjesin tjetër. Kthesa: Gruaja e Manole, Ana, mbërrin e para. Ashtu si Rozafa, ajo është e rrethuar nga muri ndërsa bërtet se muri po e shtyp. Manole përfundimisht vdes duke u hedhur nga çatia, dhe një "burim lotësh" thuhet se ka shpërthyer aty ku ajo ra.

3. Sati Chaura indiane dhe legjendat e urës

Në folklorin indian, ka shumë histori për "themelet njerëzore". Nusja e Muruar: Ngjashëm me versionin ballkanik, disa balada indiane përshkruajnë një nuse që sakrifkohet për të siguruar furnizimin me ujë të një rezervuari ose pusi të sapo ndërtuar.

Mitet e Urës: Kishte thashetheme historike (dhe folklor) se qeveria koloniale britanike ose mbretërit vendas duhej të varrosnin fëmijët nën themelet e urave të mëdha (si Ura Howrah) për t'i bërë ato të forta. 4. "Fëmija i Varrosur" Britanik dhe Nordik

Në Evropën Perëndimore dhe Veriore, legjenda shpesh kalon nga një grua në një fëmijë të pafajshëm ose një shenjtor.

Kopenhagen, Danimarkë:

Një legjendë pohon se muret e Kopenhagenit vazhdonin të shembeshin derisa një vajzë e re u vendos në një kasafortë me një tavolinë me lodra dhe ushqime, pastaj u muros e gjallë. Shën Orani (Iona, Skoci): Shën Kolumbës iu tha se manastiri i tij nuk do të qëndronte nëse një burrë i gjallë nuk do të varrosej në themel. Shoqëruesi i tij, Shën Orani, u ofrua vullnetarisht. Legjenda thotë se kur e nxorën tre ditë më vonë, ai ishte ende gjallë dhe filloi ta përshkruante jetën e përtejme në mënyrë aq të tmerrshme sa që Columba urdhëroi që të rivarrosej menjëherë për të "ndaluar pallavrat e tij".

4. Kinezja Da Sheng Zhuang i njohur si "Sakrificica e Madhe e Shtyllës":

Legjendat kineze shpesh ia atribuojnë këtë praktikë arkitektit legjendar Lu Ban. Besohej se lëvizja e tokës shqetësonte "Feng Shui" vendas dhe zemëronte shpirtrat, të cilët më pas do të rrëzonin ndërtesat nëse nuk "paguheshin" me një jetë.

**Përmbyllje:** Ne jemi pasardhës të një KOMBI të HERSHEM, që u përfshi ne tre perandori dhe përjetoi rënien e fuqisë së vet mbasi kishte arrite kulmin e civilizimit diku 4 mije deri 5 mije vjet ma pare dhe që filloi të tkurrej, që nga Lufta e Trojës e deri tek Shfaqja e Civilizimeve Monoteiste Religjioze, të cilët u përpoqën të ndërtojnë bashkësi shtetërore dhe entitete nacional-religjioze, pjese te të cilave i rezistojnë kohës.

Gjate kësaj kohe mbijetuan grimca kujdesesh, legjenda, mite dhe emra, që e kishin origjinën shumë të hershme vendase ashtu edhe emra e ngjarje të sjella në periudhën e komunikimit me vende, ngjarje e praktika që tejkalonin kufijtë e KOMBIT.

Pjese të KOMBIT asimiloheshin, duke humbur traditën dhe gjuhën, prurje të tjera ndërftueshin në bashkësinë vendase, duke marre gjuhën e traditat tona. Mesa duket, çdo here ka pas përpjekje me i bashkua përmbajtjen vendase me simbolikat e emërtimet e huazueme. Ashtu ka ndodhe edhe me Mitin e Murosjes, që mesa duket rrajat autoktone i ka ILIROSHQIPTARE; ndërsa i ka lëshuar vend emërtimit Rozafat, që vjen nga një vend i largët dhe mund të jete përdore në një kohë shumë të shkurte për të treguar vetëm Kështjellën, pikërisht në periudhën e Bizantit dhe pas Bizantit dhe sundimit të dinastisë së Nemaniqueve / Nimani, që bashkohen me Duket D'Anzhu e me Mbretërinë Bullgare.

**Mendojmë, që duhet ndryshuar emri i kështjellës "Rozafa", në Kështjella e Shkodrës, jo vetëm qç kjo kështjellë ishte dhe është e Shkodrës, historikisht, por dhe është emërtim shumë më i bukur se një emër i huaj, del sikur e kemi marre hua, për të na ngrit vlerat e kështjellës sonë, por jo, pavarësisht pozicionit të saj në histori.**

Studiuesi ALI LAÇAJ

# Alpet shqiptare, shtegtime turistike mes natyrës së egër, traditës së gjallë, tashmë dhe me struktura akomoduese të certifikuara

## NË SHËRBIM TË TURIZMIT

Alpet shqiptare, të vendosura në veri të vendit dhe të shpëlluara "Parku Kombëtar i Alpeve të Shqipërisë", me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26 janar 2022, me sipërfaqe rreth 83 mijë hektarë, po shndërrohen gjithnjë e më shumë në një nga destinacionet më tërheqëse turistike në rajonin e Ballkanit. Me peizazhe spektakolare, biodiversitet të pasur dhe një trashëgimi kulturore të ruajtur ndër breza, kjo zonë përfaqëson një potencial të madh për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt natyrës.

Në qendër të këtij zhvillimi qëndrojnë destinacione tashmë të konsoliduara si: Vermoshi, Thethi, Valbona e Lumi Gashit me fshatrat e zonat që i qarkojnë ato.

Fshati alpin i Thethit është bërë simbol i turizmit malor shqiptar falë arkitekturës tradicionale, kullave karakteristike dhe atraksioneve natyrore.

Por Alpet nuk janë vetëm peizazh. Ato janë njerëzit që jetojnë në to. Në bujtinat tradicionale, turistët priten me buzëqeshje dhe tryeza të mbushura me gatime vendase. Rritja e interesit për këtë rajon ka sjellë një frymë të re zhvillimi. Shtigjet tashmë janë më të njohura, bujtinat janë shtuar dhe turistët ndërkombëtarë po e zbulojnë gjithnjë e më shumë këtë cep të Shqipërisë. Megjithatë, sfida mbetet ruajtja e autenticitetit. Baraspesha mes zhvillimit turistik dhe mbrojtjes së natyrës është thelbësore për të siguruar që Alpet shqiptare të mos humbasin karakterin që i bën kaq të veçanta.

Rëndësia dhe domosdoshmëria e kategorizimit të strukturave akomoduese sipas ligjit dhe urdhrave përkatëse.

Ato çfarë ofron natyra në Alpe, dukshëm janë të pëlqyera dhe të vlerësuara, ky është motivi i parë për ti vizituar nga turistët. Atë natyrë me gjithë përbërësit e saj ne duhet ta mbrojmë. Mbrojtësit e parë dhe më të përkushtuar duhet të jenë ata që zhvillojnë dhe mirëpresin turistë dhe banorët vendor, që jetojnë atje. Kontributi i drejtpërdrejtë i gjithë atyre që presin turistë lidhet me pritjen, strehimin, fjetjen dhe ushqimin kjo përbën dhe sfidën më të madhe. Akomodimi është në forma dhe nivele të ndryshme.

Krahas, mbrojtjes mjedisit, promovimit dhe shtimit të turizmit në këto zona tashmë një rëndësi të madhe, domosdoshmëri për zbatim, merr kategorizimi i strukturave akomoduese sipas legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse. Ky proces përbën një element thelbësor për garantimin e cilësisë së shërbimeve, sigurisë së turistëve dhe ruajtjes së ekuilibrit ekologjik.

Së pari, kategorizimi ligjor i strukturave akomoduese siguron standardizimin e ofertës turistike. Duke përcaktuar kriteret që qarta për klasifikimin e bujtinave, hote-

leve, kampingjeve apo formave të tjera të akomodimit, krijohet një sistem transparent që ndihmon vizitorët të kenë pritshmëri të qarta për nivelin e shërbimit. Kjo rrit besimin e turistëve, veçanërisht atyre ndërkombëtarë, të cilët shpesh bazohen në kategori dhe standarde të njohura për të zgjedhur destinacionin e tyre.

Së dyti, respektimi i kuadrit ligjor ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në një zonë të ndjeshme si "Parku i Alpeve shqiptare".

Duke qenë se kjo hapësirë përmban ekosisteme të brishta dhe biodiversitet të pasur, rregulloret për kategorizimin dhe licencimin e strukturave akomoduese ndihmojnë në kontrollin e ndërtimeve, menaxhimin e mbetjeve dhe përdorimin racional të burimeve natyrore. Në këtë mënyrë, turizmi zhvillohet në harmoni me mbrojtjen e mjedisit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është formalizmi i veprimtarisë ekonomike lokale. Kategorizimi dhe certifikimi i strukturave akomoduese kontribuon në rritjen e profesionalizmit të operatorëve turistikë, në përmirësimin e kushteve të punës dhe në integrimin e komuniteteve lokale në ekonominë turistike. Kjo jo vetëm që rrit të ardhurat për banorët e zonës, por ndihmon edhe në ruajtjen e traditave dhe

kulturës lokale, duke i kthyer ato në pjesë integrale të përvojës turistike.

Nga ana tjetër, procesi i kategorizimit përballet edhe me sfida praktike, si mungesa e informacionit të mjaftueshëm për operatorët e vegjël, kostot e përshtatjes me standartet dhe nevoja për mbështetje institucionale. Për këtë arsye, është e rëndësishme që institucionet përgjegjëse të ofrojnë udhëzime të qarta, trajnime dhe iniciativa, që të nxisin formalizmin dhe rritjen cilësore të strukturave ekzistuese.

Ndoshta ndër aktet nënligjore më të fundit pas riorganizimit të saj, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ka nxjerr: Urdhër nr. 213 datë 19.11.2025 "Për miratimin e rregullores, për kushtet, kriteret, afatet, si dhe procedurën për kategorizimin e strukturave akomoduese". Kjo është botuar në gazetën zyrtare dhe është i publikuar në webin e ministrisë në lidhjen <https://mtks.al/baza-ligjore-turizem/>.

Në ligjin Nr. 93/2015 "PËR TURIZMIN" (ndryshuar me Ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017; nr. 101/2018, datë 13.12.2018; nr. 30/2024, datë 4.4.2024) përkrah në Neni 43/1

Kategorizimi i strukturave akomoduese, është shprehur qartë:

Çdo sipërmarrës turistik, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese,

brenda 30 ditëve nga regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese, paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë kategorizimi sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. Pra akti nënligjor u përmend mësipërm dhe është Urdhri nr. 213 datë 19.11.2025 i Ministrisë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Në përfundim themi, kategorizimi i strukturave akomoduese në "Parkun e Alpeve Shqiptare" dhe jo vetëm (Urdhri është për gjitha strukturat akomoduese në vend) nuk është thjesht një kërkesë administrative, por një instrument strategjik për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Ai kontribuon në rritjen e cilësisë së shërbimeve, në mbrojtjen e mjedisit natyror dhe në forcimin e imazhit të Alpeve shqiptare si një destinacion turistik serioz dhe konkurrues në tregun ndërkombëtar.

Urdhri, është në fuqi për zbatim, tashmë është një periudhë e përshtatshme për t'u njohur e zbatuar atë, duke bërë certifikimet e nevojshme para pranverës.

**Msc. Gjon Fierza,**  
**Inxhinier pyjesh**



Bujtinë në Theth

# Nënë Tereza në filateli

POR VEPRA MË E MADHE E FILATELISË SHQIPTARE, E PËRPILUAR DERI MË TANI,  
ËSHTË PËRMBLEDHJA E SHKRIMTARIT GJON MARKU ME PULLA KUSHTUAR NËNË TEREZËS,  
TË BOTUARA NË 118 SHTETE TË BOTËS.



Nga Prof. Dr. Tefë Topalli

Ky botim akademik (siç mund ta cilësojmë), me një strukturë madhore dhe me letër luksi, i përgatitur në shqip dhe anglisht, nis me një Hyrje të gjatë, ku vihet në dukje përdorimi për herë të parë i pullës postare në vitin 1864, në revistën franceze "Collectionneur de Timbres-Poste", një vit pas formimit të Shoqatës Londineze të Filatelistëve (1865), si dhe ekspozita e parë filatelike, e mbajtur në Londër më 1912. Ndërkohë, manuali "Bazat e koleksionimit të pullave", me autor Fred Malville, shënon fillimin e literaturës së mirëfilltë filatelike në botë.

Dyzet faqet e para i kushtohen Shqipërisë: një paraqitje që nis nga koha osmane dhe vijon sipas periudhave, deri para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Në shumë faqe është sjellë lëndë e pasur mbi personalitetin e Nënë Terezës, shërbimin e saj bamirës në Indi dhe në mbarë botën, vlerësimet e shumta që i janë bërë misionit të saj dhe Motrave të Urdhrit, kudo që ndodhen; vizitat në Shqipëri, përvjetorët e lindjes së saj dhe Lumturimi nga Papati.

Pas kësaj pjese nis shtjellimi përmes pullave postare me temën "Portreti i Nënë Terezës në Filatelinë Botërore", duke filluar nga shteti i Angolës e duke vijuar sipas rendit alfabetik të vendeve në të gjitha kontinentet, deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Gjon Marku, Nënë Tereza në pullat postare të botës (118 shtete) - botim dygjuhësh, EMAL, Tiranë, 2025, 462 faqe, format i madh.

Thënë drejt: ky album duhet parë dhe shfletuar, duke u njohur jo vetëm me dizenjot, por edhe me vetë pullat postare që përmban, duke reflektuar njëkohësisht mbi kontekstin historik në të cilin janë prodhuar dhe mbi funksionin e tyre social e bamirës, të lidhur ngushtë me figurën e Nënë Terezës. Po ashtu, lind pyetja nëse këto emetime filatelike kanë nxitur individë apo shoqëri drejt vetëdijesimit dhe veprimit në dobi të komuniteteve në nevojë.

Shënim: Kështu po e quajmë këtë segment, i cili është një shkrim i përgatitur dhe i dërguar në dy organe të shtypit tonë

me rastin e përvjetorit të lindjes së Nënë Terezës dhe Lumturimit të saj, por që nuk u botua, pa dhënë redaksitë përkatëse asnjë shpjegim. Ne kemi dëshirë t'ia sjellim këtë material lexuesit tonë.

## NËNË TEREZA NË FILATELINË BOTËRORE

Prej vitesh, shkrimtari Gjon Marku ka tërhequr vëmendjen e lexuesve tanë me botimet e shumta që ka publikuar në poezi dhe në prozë, në eseistikë dhe studime monografike, si dhe në ridimensionimin e figurave të shquara nga fusha të ndryshme: arsimit, kultura, politika dhe letërsia.

Ai është autor i disa librave publicistikë, veçanërisht i përmbledhjeve shumë interesante me intervista për Mirditën dhe më gjerë, të cilat kanë sjellë në mënyrë të përqendruar mendimin intelektual shqiptar dhe të huaj për mirditorin dhe psikologjinë e tij, për traditën dhe trashëgiminë historike e folklorike të kësaj hapësire malore, për mënyrën e jetesës dhe qëndresën e popullatës, sidomos për vetëqeverisjen sipas normave tradicionale, të ruajtura brez pas brezi.

Nga ky autor kemi gjithashtu studime të thelluara për Gazullorët e Mesjetës – të veshur me lavdi nga Rilindja evropiane dhe ata të kohëve tona – të trajtuar tragjikisht nga vetë shqiptarët (klerikët Gjon dhe Nikollë Gazulli), pavarësisht kontributit të tyre të jashtëzakonshëm në lëmin e lëvizjeve përparimtare sociale dhe në veprat pioniere të albanologjisë.

Ditët e fundit, Gjon Marku publikoi Albumin e madh "Nënë Tereza në pullat postare të botës (118 shtete)" – "Mother Teresa on the Postage Stamps of the World (118 Countries)", studim, Shtëpia Botuese EMAL, Tiranë, 2025, me 462 faqe.

Kjo është vepra më e madhe e filatelistë shqiptare që është përpiluar deri më tani, kushtuar kësaj Shenjtoreje. Ajo përbën një përmbledhje monumentale të shkrimtarit Gjon Marku me pulla postare kushtuar Nënë Terezës, të emetuara në 118 shtete të botës.

Ky botim akademik (siç mund ta cilësojmë), me një strukturë madhore dhe me letër luksi, i përgatitur në shqip dhe anglisht, nis me një Hyrje të gjatë, ku vihet në dukje përdorimi për herë të parë i pullës postare në vitin 1864, në revistën franceze "Collectionneur de Timbres-Poste", një vit pas formimit të Shoqatës Londineze të Filatelistëve (1865), si dhe organizimi i ekspozitës së parë filatelike, në Londër, më 1912. Ndërkohë, manuali "Bazat e koleksionimit të pullave", me autor Fred Malville, shënon fillimin e literaturës së mirëfilltë filatelike në botë.

Dyzet faqet e para i kushtohen Shqipërisë: një paraqitje që nis nga koha osmane dhe vijon sipas viteve, deri para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Në shumë faqe është sjellë lëndë e pasur mbi personalitetin e Nënë Terezës, shërbimin e

saj bamirës në Indi dhe në mbarë botën, vlerësimet që i janë bërë misionit të saj dhe Motrave të Urdhrit, kudo që ndodhen; vizitat në Shqipëri, përvjetorët e lindjes së saj dhe Lumturimi nga Papati.

Pas kësaj pjese nis shtjellimi përmes pullave postare me temën "Portreti i Nënë Terezës në Filatelinë Botërore", duke filluar nga shteti i Angolës dhe duke vijuar, sipas rendit alfabetik të vendeve në të gjitha kontinentet, deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Është pikërisht kjo pjesë që përbën thelbin studimor të veprës, e ndarë në tri periudha:

a) transmetimi i mesazheve në shoqëritë pararomake, duke nisur nga kinëzët, persët, ilirët dhe grekët;

b) gjatë Perandorisë;

c) në shekujt e parë të Mesjetës e më vonë, në marrëdhëniet ndërmjet principatave të vendeve perëndimore, sidomos pas lindjes së universiteteve në Evropë.

Autori vijon me paraqitjen e vajzës angleze, veprimi i së cilës shënon lindjen e shërbimit postar modern, si dhe të njeriut që e institucionalizoi këtë veprimtari qytetare, Roeland Hill. Këtu fillojnë edhe tarifat e para postare dhe konkurset për konkretizimin e programeve dhe ravijëzimin e pullave me çmimet përkatëse, siç është projekti i Eilium Eyon për gdhendje të stilizuara, të përdorura si modele të ndryshme.

Sipas këtij albumi, emetimi i një pulle postare ka kërkuar një kohë të gjatë stabilizimi dhe pranimit kombëtar e ndërkombëtar.

"Termi *filateli*," shkruhet në këtë vepër, "e ka zanafillën e vet në idenë e projektimit të pullës së parë postare të botës, hedhur nga suedezi Treffenberg në vitin 1823, e emetuar më 1840, me një tirazh prej 75 milionë kopjesh." (f. 8)

Thënë drejt: Albumi duhet parë dhe shfletuar, duke u njohur me deciturat (sipas vendeve dhe viteve të emetimit), me vetë pullat postare që përmban, si dhe duke reflektuar mbi kontekstin historik në të cilin ato janë prodhuar dhe mbi funksionin e tyre social dhe bamirës, të lidhur ngushtë me figurën e Nënë Terezës. Po ashtu, shtrihet pyetja nëse këto emetime kanë nxitur individë apo shoqëri drejt vetëdijesimit dhe veprimit në dobi të komuniteteve në nevojë, kudo në botë, përballë tragjedi, luftërave dhe krizave njerëzore.

... shteteve, grupeve etnike dhe katastrofave natyrore, etj.

Në këtë hyrje të pasur teorike tregohet se, me përhapjen dhe shtypjen e një numri gjithnjë e më të madh pullash postare, lindën edhe shoqatat e filatelistëve dhe të koleksionistëve në mbarë botën. Filatelia nisi të ushtrohej jo vetëm si pasion, por edhe si profesion, me të dhëna të rëndësishme historike dhe tipografike.

Ky zhvillim i nxiti shoqëritë e mëdha të organizonin ekspozita filatelike, që nga viti 1912 (Londër), dhe solli konsolidimin e literaturës së specializuar filatelike në

shkallë evropiane dhe mbarëkontinentale. Edhe nga trajta, forma dhe madhësia, pullat postare paraqesin larmi të madhe: u shfaqën pullat me dhëmbëzim (për herë të parë), të realizuara nga irlandezi Henry Archer; ndërsa format e tyre kanë qenë dhe janë të shumëllojshme: katërkëndëshe, katrore, të rrumbullakëta, trekëndëshe (në disa shtete), ovale, në trajtë rombi, etj.

Pullat e para nisën të shënojnë edhe vlerën monetare, siç është rasti i pullës së emetuar me portretin e Mbretëreshës Viktoria të Anglisë. Të gjitha këto zhvillime janë shoqëruar dhe vijnë të shoqërohen me katalogë dhe botime të shumta filatelike.

Për historinë tonë, autori bën një ndarje të veçantë kohore: "Shqipëria, vend i një dhunimi qindvjeçar të tejskajshëm otoman, 73 vjet pas pullës së parë të botës, sapo kishte fituar Pavarësinë Kombëtare dhe kishte nisur të krijonte institucionet shtetërore, emetoi për herë të parë pullën e saj zyrtare, dhe më 1913 kërkoi anëtarësimin në Bashkimin Postar Ndërkombëtar" (f. 12).

Gjatë kësaj kohe, përdorimi i pullave postare lidhej me qendrën e Perandorisë Osmane, ku emetimi i pullave postare nisi në vitin 1863, me të njëjtin shtyp dhe tarifa në tërë hapësirën e pushtuar osmane. Vulat e vëna në përdorim para emetimit zyrtar osman kalojnë nëpër tri faza:

– me shkrim osmanisht mbi një rreth të zi;

– me shkrim osmanisht në forma ovale, rrethore, katrore dhe katërkëndore, mbi sfond të bardhë;

– dhe faza e tretë, me alfabet osman dhe shkrim frëngjisht, në formë rrethore, me datë në mes.

Vula më e vjetër e kësaj periudhe i përket vitit 1849, e përdorur në vilajetin e Shkodrës, e shoqëruar po atë vit edhe me një zyrë postare; zyra të ngjashme u hapën edhe në Gjirokastër dhe Korçë.

Numri i këtyre zyrave, në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XIX, arriti në nëntëmbëdhjetë, deri në shpalljen e Pavarësisë Kombëtare. Megjithatë, duhet theksuar se shërbime të tilla kanë ekzistuar edhe në bashkëpunime të ndryshme, si: austro-turke, Antivari, pa përjashtuar shërbimet serbe, italiane, malazeze dhe greke.

Kjo periudhë lidhet edhe me depërtimin e kapitalit austriak në Gadishullin Ballkanik, kur në Shkodër Perandoria Dualiste hapi përfaqësi konsullore që në vitin 1791, si dhe përfaqësi në nivel nënkonsullate në Durrës. Në fund të shekullit XIX (1887), Vatikanin nënkroi me Vjenën edhe Kultusprotektoratin, sipas të cilit Austria merrte në mbrojtje katolikët shqiptarë të Veriut.

Austria ishte vendi i parë që hapi zyra postare në Shqipëri, edhe në kohën kur vendi ndodhej nën sundimin e Portës së Lartë, që

◀ në vitin 1854. Kryesisht përdoshin **pulla postare osmane**; njëkohësisht, zyra të tilla u hapën edhe nga **shoqëri detare**...

“**Lloid**”, për portet e Shëngjinit, Durësit dhe Vlorës. Për Shkodrën njihet gjithashtu se ka pasur raste kur zyrat postare të Konsullatës Austriake janë mbyllur, siç ishte rasti i vitit 1855, e cila qëndroi e mbyllur deri në rihapjen më 1901. Pullat e para të **Habsburgëve** mbanin prerje të portretit të **Franz Josephit**, të ngjashme me ato që përdoshin edhe në hapësirën e **Lombardisë**, Itali, e cila qeverisej nga austriakët. Ato pulla të pakta që u emetuan nga **Austria** dhe **Italia** gjatë kësaj kohe u kundërshtuan ashpër nga **Stambolli**.

Një vend të veçantë autori i kushton **filatelistë shqiptare në kohën e Pavarësisë**, kur pak ditë pas shpalljes së saj, trupat serbe dhe malazeze shkelën vendin deri në **Tiranë**. Njëkohësisht, u vunë në përdorim pulla turke, serbe dhe greke, si dhe rishtypje me mbishkrimin “Administrata greke”. Por, **emetimi i parë filatelik shqiptar** u bë nga qeveria e **Vlorës**, më **1 Maj 1913** – shtypur si zarfa me vulë postare, kur ministër ishte **L. Nosi**.

Me mjaft interes janë edhe pullat postare të emetuara nga **konsullatat e huaja në Shkodër dhe Vlorë**, pasi ato mbanin shënimin “**kombëtare shqiptare**” si dhe të “**Ministritë së Postave**”. Këto shënime reflektojnë një **formim kulturor dhe shtetëror** të një kombi që po rilindte pas një robërie të gjatë, në një kohë kur rrezikohej të zhdukej nga harta e Europës.

Autori mbyll këtë hyrje të thukët të historisë së filatelistë, duke sjellë të dhëna se kjo literaturë, në disa vite, është hartuar nga studiues të huaj, si: **Friedrich Ęalich**, *Albanien und seine postverlichen*, Vienë, 1941; **Helmut Schapacha**, *Geheimnisvolles Briefmarkenland Albanien*, Gjermani, 1987; si dhe nga librat e fundit të **Phipps**. Megjithatë, ai që shfleton këtë album me vëmendje kupton se, për gjysmë shekulli, **filatelia shqiptare zhvillohej ndryshe nga bota e qytetëruar e filatelistë**, përcaktuar nga **vetëizolimi që Shqipëria i bëri vetës** në rrugën e përparimit shoqëror.

Duke vizualizuar strukturën e këtij albumi të jashtëzakonshëm, duhet vënë në dukje se ai është **i radhitur me një metodikë të mirëmenduar**, filluar nga faqet 23–44, jo kronologjikisht sipas jetës së Nënës së Shenjtëruar, por me ndarje studimore që ka bërë autori.

Veçanërisht tërheq karakterizimi i thellë që i bëhet kësaj Shqiptareje të Madhe: “Nuk mund të ketë ambasador apo trupë diplomatike që me aq dinjitet të përfaqësojë Shqipërinë në arenën ndërkombëtare, që të kontribuojë dhe të japë aq shumë dinjitet dhe krenari për çdo shqiptar kudo në botë, sa Nënë Tereza.” (f. 23)

Pas një **CV-je të shkurtër** dhe nderimeve që i janë bërë Nënë Terezës nga forumet kulturore dhe institucionet shtetërore, kombëtare dhe ndërkombëtare, siç është **Çmimi Nobel (1999)** – i cili Ajo e pranoi gjithmonë me **kokën ulur dhe modestinë e pashoqe** – autori na njeh edhe me vlerësimet e saj nëpër **emetime pullash postare** në përvjetorë të ndryshëm pas ndërrimit të jetës, deri te **Lumturimi dhe Shenjtërimi i Saj**.

Autori shpreh vlerësimin në radhët e mëposhtme:

“Ne, kombi shqiptar, jemi me fat të madh, fat që vetë Zoti na privilegjoj, që nga gjiri i Kombit tonë të lindte një **Gonxhe**, një femër, një grua, një nënë bujare me shpirt dhe zemër të pastër qelibar. Që ajo Gonxhe të shpërthente lulet e petaleve të saj me humanizmin e vet në mbarë njerëzimin. Jo të gjithë kombet e kanë një fat të tillë të madh e të rrallë, fatin që patëm ne, që nga gjaku ynë të lindte një **Legjendë**, fat që do ta dëshironin të gjithë kombet...” (f. 29)

Shkrimtari **Gjon Marku** e ka ndarë Albumin në disa **rubrika emetimi të pullave postare**, ku vendin e parë e zë **Shqipëria**, toka që e lindi këtë **Nënë të mbarë Dheut**.

Në rendin e parë dalin “**Portretet e Nënë Terezës**”, që nga numri i pullave arrijnë në **162**, me portret të Nënës në gjendje emocionale mjaft të ndryshme – të emetuara nga **71 shtete**, nga Argjentina, Angola, Austria... deri tek Uganda, Vatikani dhe Xhibuti.

Rendi i dytë emërtohet “**Nënë Tereza dhe Papa Gjon Pali i Dytë**”, i sjellë në **58 variante** nga **25 shtete të botës**, ku vendin e parë e zë Turkmenistani (1979), ndërsa Mali dhe Sierra Leone kanë numrin më të madh të pullave me këta të dy.

Rendi i tretë përfshin pullat postare ku **Nënë Tereza është në shoqërim me Princeshën Dajana**, me **33 variante** nga **19 shtete**; princesha e Ęells-it ishte e njohur për mbështetjen e bamirësisë, demilitarizimin tokësor dhe ndihmën ndaj të prekurve nga **AIDS-i**.

Së katërti, vjen titulli “**Nënë Tereza me fëmijët**”, ku Nëna e papërsëritshme nuk mund të ishte larg moshës së re të një brezi që jep dhe kërkon vetëm dashuri; janë **83 variante** nga **34 shtete**, duke i

Një ndarje më vete ka bërë autori për **pullat postare të emetuara në Shqipëri pas viteve 1990**:

1991, 1992, 1994, 1996: “**Gra të shquara – Nënë Tereza**”, 11 seri dhe 33 vlera filatelike;

1997: “**Homazhe për Nënë Terezën**”;

1998: “**Përvjetori i vdekjes së Nënë Terezës dhe Princeshës Dajana**” dhe “**Përvjetori i vdekjes**” (emisioni i përbashkët me Italinë);

Dhjetor 2001: “**100-vjetori i Çmimit Nobel**”;

2003: “**Lumturimi i Nënë Terezës**”;

2007: “**Dhjetëvjetori i vdekjes së Nënë Terezës**”;

2010: “**100-vjetori i lindjes së Nënë Terezës – Gonxhe Bijaxhiut**”;

2016: “**Shenjtërimi i Nënë Terezës**”.

Autori pasqyron gjithashtu emetimet për **hapësirën e Kosovës dhe të RMV**, duke i dhënë Albumit një fytyrë të plotë **shkencore dhe dokumentare**. Ai ka renditur edhe **literaturën bibliografike** të përdorur gjatë vjeljes së materialit, duke e forcuar dimensionin studimor të veprës.

**Pjesa II** e veprës, që zë hapësirën më të madhe të Albumit (**faqet 45–359**), titullohet: “**Portreti i Nënë Terezës në Filatelinë Botërore**”. Kjo pjesë është e renditur **alfabetikisht**, faqet 47–119 përmbajnë **foto personale të Nënë Terezës**, përgjithësisht duke buzëqeshur gjatë veprimtarisë së saj misionare, por edhe me pamje të menduara dhe rrallëherë të shqetësuara...

Problemet që ajo ka pasur, siç pohojnë biografët e saj shqiptarë dhe të huaj, shfaqen qartë në disa pulla postare; me shikim të ngrysur, ajo shfaqet në shtetet e **Buriantia-s, Burkina Faso-s, Butanisë, Çadit, Republikës Domenikane, Grenadës, Guinesë, Guajanës, Gjermanisë,**

këtë bashkëpunim simbolik në filatelinë e tyre.

Një vëmendje të veçantë meritojnë edhe pullat ku **Nënë Tereza shfaqet me Princeshën bamirëse Dajana**; duket qartë se **G. Bojaxhiu** çmonte veprimtarinë sociale dhe kujdesin për fëmijët që realizonte Princesha, dhe njëkohësisht bindesh se Princesha e Ęells-it kishte Nënë e Madhe si idhull të jetës së saj. Në këto portrete, të dyja shfaqen duke buzëqeshur dhe të kënaqura nga misioni i tyre për paqe dhe shërbim njerëzor – **E Vogla e Madhe dhe E Gjata e Vogël** përbëjnë një **unitet mirësie dhe misioni shpirtëror të përbashkët**.

Biografët e shquar të Nënë Terezës, si **don Lush Gjergji** dhe prof. **A. Berisha**, të cilët kanë hartuar jetëshkrime dhe libra për veprimtarinë e saj, përshkruajnë episode të ndryshme me personalitete të fushave të ndryshme. Këtu shpjegohet qëndrimi dhe gjendja psikologjike e Nënës, shqetësimet dhe gëzimet që ajo përjetoi për institucionet që drejtoi, duke qenë një veprimtare e **përlul brenda tyre**, në barazi me simotrat e veta.

Kur i buzëqesh **Yasser Arafatit**, shikimi i saj i përqendruar tregon mendjen tek të vrrarët e luftës dhe armëpushimet që vendosen për nder të saj. Po ashtu, me **Mahatma Gandhin**, buzëqeshja e saj shpreh shpresën për pavarësinë e një populli të madh, siç ishte India, dhe optimizmin për të përballuar urinë dhe varfërinë që prekte popullin.

Kjo është pjesa më e **bukur dhe domethënëse** e Albumit, shfaqur në ndarjen “**Nënë Tereza me fëmijët**” – hapësira më delikate për një grua të famshme, e quajtur Nënë e mbarë njerëzimit, e cila vetë nuk ka provuar mëmësinë e vërtetë. Fëmijët që ajo mban në prehër, në duar apo në gjoks, nuk janë fëmijë të shëndetshëm e të bukur, por fëmijë lebrozë, të sëmurë, paralitikë dhe të uritur, pa kujdes shëndetësor. Megjithatë, ajo shfaqet **gjithmonë e qeshur dhe me shpirt të hapur**, me shikim shprese dhe vizion ndryshe nga gjendja e vërtetë e tyre.

Fëmijët janë me sy të lotuar; Ajo i mbështjell në krahë, duke i mbrojtur nga **vdekja, sëmundja dhe harrimi**, nga braktisja dhe fatkeqësitë. Nënë Tereza **nuk ngryset para tyre**, hijen e zezë ata e shohin si një rrobe të përherëshme, ndërsa Nëna mundohet t'i gëzojë dhe t'i veshë me **dashuri dhe shpresë për të ardhmen**.

Ky Album i rrallë, në gjithë treguesit e tij, është një **vepër monumentale për filatelinë**, kushtuar një figure aq të njohur të **humanizmit dhe hyjnizimit të njeriut**, mbi të gjitha ngjarjet materiale të botës: **Nënë Terezës**. Ai mbetet aktual edhe për ngjarjet e sotme, të mprehta dhe të mbarsura me pasoja aq të rrezikshme, kur **luhet me zjarrin** dhe kërcënohet vetë ekzistenca e njeriut.

Albumi përbën një **histori, traditë, sakrificë dhe triumf**, duke shërbyer gjithashtu si **thirrje për zgjidhjen e problemeve kardinale të mbarë botës**. Kjo vepër dallon nga të gjitha botimet e tjera të realizuara nga autori; është një **arritje në një fushë jashtëletrare**, që ka kërkuar kohë, durim, përpjekje dhe saktësi, një **vizion planetar** për t'u realizuar, që vetëm **shkrimtari Gjon Marku**, a utor i mbi 30 librave, mund ta kishte përballuar me sukses.



dhënë kësaj teme një dimension të ri filatelik **mbarëbotëror**.

Rendi i pestë mban emërtimin “**Nënë Tereza me personalitete**”, një atribut që ajo nuk e synonte asnjëherë si madhështi në jetën e saj të përvojatur. Ajo ka pranuar të takohet me personalitete shtetërore si **Mbretëresha Elizabeta II e Mbretërisë së Bashkuar**, presidentë e kryetarë shtetesh, princa dhe diktatorë, si dhe me figurat e shquara: **R. Regan, Nelson Mandela, Yasser Arafat, Mahatma Gandhi, Jaëaharlal Nehru**, dhe edhe me **Gina Lolobrigidën**. Janë **12 shtete** që kanë emetuar pulla me portretin e saj, të shoqëruara me këta dinjitarë, me gjithsej **33 variante**.

**Irlandës, Kroacisë, Malit, Mozambikut,** etj.

Në pulla të ndryshme postare, portreti i saj vjen i realizuar sipas **pikturave dhe skicave**, ndërsa portrete të veçanta, me pamje ekspresive dhe interpretuese psikologjike, gjenden në **Shqipëri dhe Francë**. Shumë tërheqëse janë portretet e pullave të **Xhibutit** (f. 119), ku shprehësia e fytyrës së saj mbetet e veçantë.

Duket qartë se **Papa Gjon Pali II** ka pasur një adhurim të veçantë për Nënë Terezën, e cila çmohej pa kufi prej tij; në pulla ajo shfaqet gjithmonë në bashkëbisedim me të, duke përfshirë edhe lëvizjet e duarve dhe vështrimin e përqendruar. Shumë shtete kanë zgjedhur të përdorin

# Tolerancë zero ndaj çdo forme dhune që tregohet me fëmijët dhe adoleshentët



FRAN GJOKA

Ngjarjet e rënda të ndodhura për vitin 2025 në mes adoleshentëve tronditi rëndë mbarë opinionin publik shqiptar. Sherbimi Social, si institucion në vete, të ketë në përparësi që çdo punonjës i shtetit shqiptar që merr përsiër një detyrë kaq fisnike, të kalojnë paraprakisht në test shumë të rreptë. Çdo edukator apo punonjës të tjerë të sherbitit social. Kjo duhet shoqëruar edhe me përmirësimin e sistemit ligjor duke u siguruar të drejta të plota fëmijëve jetim apo me probleme të ndryshme. Vetëm kështu sigurojmë standartet e duhura europine.

Lind pyetja: Cilët janë elementet e dhunës dhe detajet e format e shfaqjes së saj me fëmijët dhe të rriturit?

Dhuna është fenomen sa social aq edhe socialpsikologjik. Si formë e ushtrimit të forcës për të dëmtuar dikë tjetër emocionalisht, psikologjikisht dhe fizikisht, ajo, fatkeqësisht është e pranishme ende në shoqërinë shqiptare në tërësi, në shkollë dhe në institucionet e tjera të edukimit e pse jo edhe në nivelet e ndryshme të shtetit dhe më gjërë..

Ne kemi një mision fisnik dhe detyrim edhe moral që këtë dukuri negative të një shoqërie me demokraci ende të brishtë ta njohim në shumëanshmërinë e saj, ta analizojmë në thellësi duke u munduar që të gjejmë burimin, të përcaktojmë pasojat dhe mbi këtë bazë të marrim masa për ta parandalur atë. Së paku të ulim ndjeshëm intensitetin dhe pasojat.

Fatëkeqësisht dhuna është e pranishme në mjaft raste në komunitet, në institucione të shtetit dhe në kompani e firma private, në rrugët dhe në rrugicat e vogla në thellësi të pallateve, në familje... Aq më e papranueshme është ajo edhe në shkollë.

Me që ju flisni për elementë të dhunës dhe më gjërë, a mund të na tregoni më në detaje diçka për perceptimin tuaj për dhunën dhe për format e saj të shfaqjes?

Shpesh herë perceptimi për dhunën është i kufizuar. Dhuna më së shumti perceptohet si e tillë vetëm në rastet e ushtrimit të forcës fizike të një individi apo grupi social ndaj një individi ose grupi tjetër social, që në raste ekstreme ka kosto të lartë që shprehet edhe me humbje

jetësh, për shkaqe të pamotivuara, që në media përdoret rëndom termi "për arsye banale".

Në pamjen e saj të vërtetë dhuna shfaqet në formën e dhunës institucionale, sociale, seksuale, emocionale e psikologjike në tërësi, fizike dhe fizike ekstreme etj. Asnjë nga institucionet nuk është realisht i imunizuar nga format e dhunës. Natyrisht në mjediset e institucione të ndryshme ajo ka dinamikë të ndryshme. Vetëm për të krijuar një perceptim më të plotë për elementët dhe format e dhunës në tërësi le t'i referohemi disa rasteve ku ajo shfaqet, si rregull, në mjedisin tonë social e kulturor, pa iu referuar rasteve të politikës, ku dhuna "qarkullon" me shumicë". Natyrisht kjo formë e saj nuk është objekt i kësaj interviste, pavarësisht se ajo gjeneron dhunë në komunitet, në institucione dhe në strukturat e tjera të pushtetit lokal.

Për shembull raste të dhunës shfaqen vertikalisht në të gjithë piramidën e shtetit. Më e theksuar është ajo në ato institucione ku përkeqësohen marrëdhëniet, ku fryma e grupit rëndohet si pasojë e përpjekjeve të drejtuesve për të shfrytëzuar pushtetin deri në abuzim të tij, më qëllim "që të disiplinohet" puna në institucion apo në ndërmarrje.

Po kështu e përhapur është edhe dhuna sociale, "viktimit" e së cilës janë kryesisht fëmijët dhe adoleshentët e tërhequr nga jeta e grupit, që rrinë disi larg shokëve dhe shoqeve në shkollë dhe në mjediset e tjera shoqërore. Për arsye nga më të ndryshme ata nuk integrohen me mjedisin psikokulturor ku e kalojnë kohën dhe rriten. Jeta e vetmuar është tipar dallues i këtij grupimi. Fëmijë të kësaj natyre ndjehen keq psikologjikisht dhe emocionalisht, ndjehen disi të huaj në vendin e tyre.

Po kështu të dukshme janë edhe rastet e dhunës fizike të shprehur në përdorimin e forcës së një individi ose grupi ndaj një individi dhe grupi tjetër social. Është e pranishme në komunitet, në familje ndaj fëmijëve dhe bashkëshorteve dhe individëve të tjerë të pambrojtur. Jo më pak e pranishme është dhuna fizike edhe në shkollë, në institucionin e vetëm të edukimit që jep arsim dhe edukatë në mënyrë të organizuar.

Me format e dhunës emocionale, që shprehen virtualisht, pothuajse jemi socializuar në një masë të caktuar të gjithë. Rëndom shohim ose jemi në rolin e atyre që e ushtrojnë këtë dhunë ku punojmë dhe jetojmë. Fjalët ofenduese që e dëmtojnë emocionalisht bashkëshortin ose bashkëshorten, nxënësin, punonjësin, shokun e shoqen etj, na shoqërojnë në të shumtën e herës. Siç duket, një formë e tillë dhunë, kur krahasohet me dhunën që të dëmton fizikisht, ose që padrejtësisht e hedh punonjësin në rrugë, nuk ka ndonjë peshë të madhe në jetën e individit tek ne. Ndonëse në një shoqëri të lirë dhe me de-

mokraci të zhvilluar edhe kjo dhunë është e papranueshme.

Dhunën institucionale e ushtrojnë drejtues me formim kulturor dhe profesional të cunguar, që inferioritetin e tyre intelektual përpiqen "ta kompensojnë" me forcën e pushtetit të përkohshëm që mund t'u jetë dhënë për çdo lloj kontributi, me përjashtim të atij profesional e kulturor në tërësi.

Elementët e dhunës fizike përdoren në familje ndaj fëmijëve dhe jo vetëm, nga baballarë dhe më rritur, që e përdorin alkoolin dëndur dhe deri në atë masë sa kjo kategori bëhen vartës ndaj pijes. Sa më shumë alkool që ata përdorin aq më të dhunshëm shfaqen në familje. Pjesë e grupimit të kësaj dhune janë edhe baballarët dhe bashkëshortët që mendojnë shpesh herë negativisht për sjelljen e fëmijëve dhe të grave të tyre. Niveli i ulët kulturor dhe formimi i pakët qytetar, diferencat e mëdha në disa raste mes çifteve dhe xhelozia, më së shumti si fenomen se sa si realitet, i bën një kategori burrash të dhunshëm. Në psikikën e tyre sundon forca dhe kultivimi i frikës, në vend të logjikës dhe të arsyes.

Ajo që e trazon shpirtin e qytetarve sot tek ne, është edhe varfëria, pamundësia e një grupi për të siguruar kushtet minimale të jetesës, si dhe problemet e mëdha që kanë me pronat, ku në mjaft raste vepron "Maliqi" dhe jo ligji, ku pronarët pa prona janë bërë e po bëhen padrejtësisht me prona. Në pamundësi për të gjetur zgjidhje nga strukturat përkatëse të shtetit dhe të shoqërisë, njerëzi dalin jashtë kontrollit, nuk i kontrollojnë emocionet e tyre. Në këto kushte sjellja agravon dhe bëhet, siç po ndodh pothuajse përditë, konflikuale dhe me pasoja.

Dhunën seksuale e ushtrojnë kryesisht individët me deformime dhe çrregullime narciste të personalitetit. Ata janë kryesisht manjakë dhe shumë të rrezikshëm për shoqërinë.

Shikoni, me përjashtime shumë të rralla, dhuna në të gjitha format e saj nuk ka efekte pozitive, pavarësisht se ku dhe ndaj kujt ushtrohet. Imagjinoni një drejtues shkolle ose institucioni, i cili nuk di ose komunikon me të meta me punonjësit, që nuk ka aftësi t'i menaxhojë mirë punët, që në vend të logjikës, argumentit dhe arsyes përdor mosarsyen, unin dhe forcën e pushtetit provizor, që bie viktimë e deformacioneve që mund të marrë ose merr nga "shoqet dhe shokët" e saj, që i shikon nga lart dhe nga larg vartësit, mësuesit, kolegët dhe nxënësit, që ... Çfarë ndodh në të tilla kushte? Pa u ndjerë futet fryma e përçarjes, e frymës që nuk i shërben punës, kultivohet autoriteti i rremë dhe mungesa e mosbesimit mes individëve dhe palëve, ndërtohen marrëdhënie të ndera etj. E keqja është se kjo frymë dhe formë drejtimi, e shprehur në

formën e dhunës institucionale, përcillet deri tek punonjësi më i thjeshtë deri tek vartësit më të largët dhe tek nxënësit. E gjitha kjo e dëmton punën dhe vetë personat që "vishen me kostume" të tilla të përkohshme të autoritetit fallco dhe të dale tashmë nga moda.

Në shkollë dhunën nda nxënësve e përdorin mësuesit me formim të dobët, sidomos profesional. Në pamundësi për të komunikuar me adoleshentët me gjuhën e tyre, ndodh që mësues të veçantë bëjnë presion përmes notës tek nxënësit, i shohin ata me një farë përçmimit dhe në pozitat e njeriu që, sipas tyre, i di të gjitha, paçka se një grup nxënësish dhe studentësh mund të dinë më shumë se mësuesi ose pedagogu i tyre. Ku bëhet mësim me të meta, ku individë dhe grupe nxënësish nuk merren me punë gjatë mësimin, ata bëhen "shkaktarë" të prishjes së mësimin. Në këto kushte për ta "disiplinuar" klasën vepron mësuesi autoritar (jo me autoritet) dhe përmes dhunës "vendos" qetësi, ose i duket atij se e arrinë një gjë të tillë, paçka se pasojat mund të jenë aq të mëdha sa ky lloj mësuesi nuk i parashikon. Fjala vjen një konflikt i pa menduar mund ta çojë shtrirjen e tij në familje, rrjedhimisht ai sjel shumë pasoja për të gjithë palët.

Në familje dhuna ndaj fëmijëve kultivon dhunë, e cila transmetohet, si rregull, edhe tek brezat pasardhës. Dhuna fizike, ndryshe nga arsyeja dhe komunikimi i hapur, kultivon frikë dhe ankth që e dëmtojnë shumë personalitetin dhe karakterin e fëmijëve në formim e sipër.

Si përfundim: Në këto kushte aktuale, ç'mund të bëjmë?

Të gjithë kanë detyrime për mënjanimin e dhunës: shkolla, familja, shoqëri civile, institucionet, shteti dhe strukturat e tij, shoqat që veprojnë etj. Ne duhet të ndryshojmë pak e përditë mendimin se dhuna është mesjetar, se civilizimi dhe qytetaria nuk e pranojnë atë. Po ndryshuam mendimin do të krijojmë baza për t'u fokusuar më mirë në kultivimin e vlerave të një demokracie pa dhunë.

Mendoj se në mes këtyre institucioneve shkolla dhe familja kanë shumë përgjegjësi dhe detyrime, se ato duhet të veprojnë në mënyrë të kualifikuar dhe së bashku për ta arritur qëllimin për të cilin po flasim.

Gjykoj se ka ardhur koha që, krahas përmirësimeve në sistemin e punës së shkollës dhe të fakulteteve të mësuesisë, të hidhen hapat e para për trajnimin e prindërve, pasi ata kanë shumë të meta në njohjen e moshës, të mënyrës së sjelljes dhe të komunikimit sidomos me adoleshentët. Vetëm kështu shkollë - shkollë klima do të zbutet dhe shoqëria do të emancipohet. Për rrjedhojë edhe dhuna do të pakësohet dhe me kalimin e kohës do të shkojë drejt zhdukjes.

# Fran Ivanaj, simbol i qëndresës për mbrojtjen e flamurit dhe kufijve tanë detarë



Dr. Marash NDOKA

Në datën 15 Dhjetor 2025, u mbushën 50 vjet nga dita e rënies së Heroit të Popullit Fran Ivanaj. Kjo përbën një datë historike në jetën e popullit të krahinave tona e më gjerë.

Frani u lind më 29 shtator të vitit 1944, në Malin e Rencit të rrethit të Lezhës.

Ivanajt, si shumë malësorë të Malësisë së Madhe kanë zbritur nga zona e Shkrelit. Gjyshi i Franit, Kolë Ivanaj, ka luftuar dhe është masakruar nga serbët e e ka vdekur nga plagët e marra prej tyre. Që në fëmijëri, Frani dhe gjithë malësorët e Veriut, janë njohur me incidentet dhe masakrat që kanë shkaktuar mbi ta shovinistët serbë.

Në moshën 14- vjeçare, Frani filloi punën në peshkim dhe pasi përfundoi Shkolën e Peshkimit në Durrës, ai u bë kapiten barke, një nga më të zotët e flotës së peshkatarëve të Shëngjinit. Aty, ai që herët u njoh me vështirësitë e punës e sidomos me ato të detit si edhe me heroizmat e detarëve e provokacionet që bënin fqinjët tanë në kufijtë detarë. Duke punuar e jetuar në qytetin e Shëngjinit, ai u njoh me historinë e këtij qyteti 2300 vjeçar. Porti dhe deti me të mirat e tij kanë shërbyer si burim mirëqenie për popullsinë e zonave bregdetare, por siç dihet nga deti kanë ardhur edhe shumë pushtues. Një gjë duhet theksuar, se është e vërtetë se nga deti kanë ardhur shumë pushtues por është po kështu e vërtetë se sa herë kanë ardhur ata kanë hasur në rezistencën e popullit të këtyre anëve.

Mjafton të përmendim 2- 3 shembuj për të vërtetuar këtë. Kështu gjatë periudhës së Lidhjes së Prizrenit kanë zbarkuar shumë ushtarë turq për të vajtur e mposhtur Lidhjen e rezistencën e popullit të Ulqinit dhe Tivarit por janë pritur me armë.

Në vitin 1911, ushtritë e tjera armike kanë ardhur për të shtypur lëvizjen e Malësisë së Madhe, por janë zbrapsur në det.

Më 7 prill 1939, forcat e xhandarmërisë dhe populli i Shëngjinit bllokuan për disa orë fashistët italianë që zbarkuan në Shëngjin, çka bëri që ky qytet të futet në histori si vendi i parë në Shqipëri që së bashku me Durrësin, Vlorën e Sarandën filloi luftën kundër fashizmit.

Me këto e shembuj të tjerë historikë e patriotikë u formula edhe Frani ynë. Ne bashkëmoshatarët e tij e njohim atë si atdhetar të vërtetë, si një burrë të pjekur para

kohe që fliste pak e punonte shumë e që printe gjithmonë në ballë të vështirësive si shok i mirë e familjar i rregullt. Prandaj nuk ishte rastësi që Fran Ivanaj ta kryente këtë akt të lartë heroik.

Më datën 15 Dhjetor të vitit 1975, një anije pirate jugosllave filloi provokacionin kundër anijes “Islam Mustafa”, kapiten i së cilës ishte Frani. Ata e kishin “bërë zakon” që t’i dhunonin anijet tona, sidomos anijet peshkatarë të paarmatosura. Kërkonin të hynin në anije, t’u hiqnin flamurin kombëtar dhe simbolet e tjera, t’i merrnin në arrest e t’i dërgonin në portet e tyre. Por këtë turp kombëtar, këtë fyerje të rëndë nuk mund ta pranonte Frani dhe shokët e tij. Prandaj vendosën më mirë të vdesin se të dorëzohen. Për disa orë ata luftuan trup më trup me forcat armike që ishin 5-6 fish më shumë dhe të armatosur me armët e kohës. Me forcën e krahut dhe mjetet rrethore u rezistuan forcave armike. Këta të fundit as nuk arritën të të hipnin në anije dhe as ti merrnin në arrest. Kur panë se nuk e mposhtën ekuipazhin e anijes, armiqtë qëlluan për vdekje kapitenin trim Fran Ivanaj. Pas vrasjes së Franit, drejtimin e mori 16- vjeçari Nikolin Çobani dhe ekuipazhi vazhdoi udhëtimin drejt bregut për të sjellë anijen me trupin e heroit në tokën mëmë.

Kam qenë dëshmitar i ngjarjes dhe kur po vinin anijet tona drejt bregut, mbërriti në Shëngjin familja e Fran Ivanajt me në krye nënën Gjyste. Sapo erdhi në port ajo ju drejtua njerëzve që po e prisnin: “A kam përse t’ua jap dorën, a e ka dhënë jetën si burrë djali im?”. Këto fjalë të saj ngritën peshë zemrat e gjithë ne pjesëmarrësve. Ku e gjeti forcën kjo nënë afro 60 vjeç për të mposhtur dhimbjen e madhe të humbjes së djalit? Ku i gjeti këto fjalë aq trimërore e burrërore kjo grua?

Fran Ivanaj u përcoll në banesën e fundit me nderimet më të mëdha nga populli i rrethit të Lezhës e shumë të tjerë të ardhur nga Malësia e Madhe, Shkodra, Kruja, e të tjerë. Erdhën aq shumë njerëz sa nuk i zinte “Kodra e Marlekës”. Në shpirtin e tyre ishte dhimbja e madhe për humbjen e Franit, por edhe revolta për këtë akt armiqësor që kryen serbo- mala- zezët.

Mbas këtij akti Frani u shpall “Hero i Popullit” dhe për të u shkruan libra dhe shkrime të ndryshme, u bënë këngë dhe u ngrit Muzeu i Shëngjinit kushtuar


heroizmit detar, një pavijon, të të cilit e zinte akti atdhetar i ekuipazhit të anijes “Islam Mustafa” dhe kapitenit të saj.

Në qytetin e Shëngjinit u ngrit lapidari kushtuar kësaj ngjarjeje, që ka mbetur simbol i heroizmit në mbrojtjen e kufijve tanë detarë.

Vit për vit u përkujtua kjo ngjarje dhe shërbeu për edukimin atdhetar të rinisë e popullit tonë. Por dua të theksoj se në periudha të veçanta heroizmi i heronjve dhe dëshmorëve tanë shpesh është harruar. Ka disa dritëshkurtër që e kanë në dyshim si heroizmin e të rënëve të periudhës së luftës dhe atyre të pasqirimit. Muzetë, lapidarët e të gjithë simbolet përkujtimore nuk u vlerësuan sa duhet. Veçanërisht marrëzia shqiptare e vitit 1997 që shkatërroi çdo gjë prishi edhe lapidarët, muzetë e të gjithë simbolet e tjera përkujtimore. Për rrjedhojë nuk ka ku të pasqyrohet heroizmi i luftës dhe i ditëve tona. Këto janë veprime të shëmtuara. Heronjtë, dëshmorët, veteranët, partizanët dhe të gjithë ata që luftuan dhe dhanë jetën për këtë tokë janë gjerdani i artë i popullit tonë, janë kujte-

sa historike pa të cilën nuk mund të ecet përpara. Duke kujtuar luftën dhe lavdinë tonë, ne tregojmë se dikush jemi, se ky vend ka patur dhe ka zot, se ky truall është mbrojtur me gjak dhe sakrificë. Prandaj bëj apel për organet shtetërore, shoqatat e ndryshme, partitë politike, shkollat si vatra të mësimi e të edukimit që ta përmirësojnë rrënjësisht punën për ruajtjen, pa- surimin dhe pasqyrimin e historisë tonë, për të ndikuar në edukimin atdhetar të popullit e sidomos të brezit të ri. Ky është një aspekt i rëndësishëm i punës tonë për të bërë që populli e sidomos rinia ta duan më shumë Shqipërinë, të kenë më shumë besim tek e ardhmja e saj, të përpiqen e të kërkojnë për ta ndërtuar lumturinë e tyre këtu në atdheun tonë e jo të ikin nga sytë – këmbët.

Mënyra sesi jetoj Fran Ivanaj, si e ndërtoi ai jetën e tij për aq kohë sa jetoj, si e deshi atdheun e të parëve dhe “si e dha jetën”, është një burim frymëzimi për të gjithë.



# Tentakulat e luftës së klasave

Ndonëse kaluan mbi 3 dekada dhe Shqipëria po ecën në të njëjtat shina. Mëndja të thotë, se mos jemi komb që nuk mund të jetojmë të lire. Ne jemi mësuar me të keqen dhe nuk mund të jetojmë pa të. Pas viteve 1990 kur regjimet diktatoriale e humbën pushtetin, diku me dhunë e diku me luftë. Tek ne pati një kalim pushteti pa shumë dhimbje. Meritë e klasës politike të kohës. Konceptet demokratike filluan të shfaqen edhe tek ne. Kryesorja ishte braktisja e luftës klasave. Fatkeqësisht ma e madhe që kishte pllakos Shqipërinë për shumë vite. Viktima e të cilave kishin qenë: Intelektualet, të pasurit (biznesmenët) Shërbëtorët e kulteve fetare e të gjithë atyre që kishin qenë dikush. Përmirësime të dukshme pati se u bë lirimi fesë, fjala e lire i pronës mbi token, po edhe njohja pronave të ish pronarëve dhe mbi të gjitha lirimi i të gjithë të burgosurve politikë.

Vuajtjet e shqiptarëve nuk mund të shkruhen edhe sikur toka të bëhet letër dhe deti bojë, 6000 persona të zhdukur për arsye politike. Më i godituri ishte Shkodra, e cila numëronte rreth 40 000 banor, me 26 burgje. Në Qarkun e Shkodrës më të diskriminuar ishin Dukagjinasi, ose për çdo 1 500 banor një qeli. Nuk do ndalemi në këtë shkrim se ato i mbeten historisë.

Jetuam në një kohë, kur njeriu ishte robot dhe duhej përqendruar atyre rregullave të vendosura nga diktatura? Kapërcelli, që kaluam në vitet 90 -ta, menduam se i lame pas gjithë ato të këqija. Kapërcelli u kalua, po ku ramë??? Pas 35 viteve notojmë në të njëjtat ujëra, shpesh here edhe më të pista. Ka shumë mendime, që shprehen se ishim më mirë kur ishim keq. Në mendje i vijën siguria për jetën, rendi e qetësia, shëndetësia njësoj për të gjithë dhe falas, e mbi të gjitha familja ishte e shenjtë. Nuk mund as të mendohej ndryshe vetëm burrë e grua e të tjera. Nuk harrojmë se gjendja ekonomike ishte në minimumin jetik, të paktën pas viteve 1980. Në kohën e tufëzimit të oborrit kooperativist, rënia e prodhimit, industrial, bujqësor e blegtoral, radhët për një litër qumësht, taloni e të tjera. Përsëri qëndrojmë, se ishim mirë kur ishim keq. Në fillimet e demokracisë, pati shenja se Shqipëria fillojë rrugëtimin drejt demokracive Perëndimore, filloj integrimi i të përndjekurve e të persekutuarve politik, u bane kompensime ndonëse me pikatore e të tjera. Zbatimi ligjit 7501, për token, ndonëse pati shumë kontestime morën tokë në fushë mijëra familje. Çfarë ndodh sot??? Thirrje për bashkim pa urrejtje, bënë shumë profesor, intelektual, shkrimtar e gazetar të njohur. I madhi Martin Camaj, në vitin 1992 bëri thirrje: "Avitu, njeri! Afrohuni shqiptar! Nga poli i urrejtës dëshiroj me dalë. Si bima prej fare në pranverë"

Polarizimi pushtetit ka bërë, që njerëzit në këtë vend te bekuar të mos kenë mundësi të krijojnë të ardhmen e tyre.

Sot lufta e klasave zhvillohet në mesin e

kampeve politike. Format e luftës së klasave janë të ndryshme. Konfliktet klasore mund të zbulohen nëpërmjet:

a- Dhuna e drejtpërdrejtë, si vrasjet, grushte shteti, revolucionet e të tjera.

b- Dhuna indirekt, si vdekje nga varfëria, keq ushqyerja dhe vendet e pasigurta të punës.

c- Shtrëngimet ekonomike, si bojkotet, grevat, kërcënimin, papunësisë e të tjera.

ç- Makinacionet politike nëpër mjet lobimit të paligjshme. Ndalimi i referen-



dumeve, shtypja e votuesve dhe heqja e të drejtës së votës.

d- Lufta ideologjike me anë të propagandës dhe literaturës politike.

Nga këto vetëm pika "a"- nuk na përket ne si shoqëri. Tentakulat e të tjerave janë aktuale në vendin tone. Akoma pa marrë pushtetin projektohen ndarja e vendeve të punës në mes të militantëve, patronazhanistëve dhe lidhjeve familjare, fare e fisnore deri në atë krahinore. E themi krahinore, sepse nga 4 qarqe të veriut në kabinetin qeveritar Rama - 4 nuk ka asnjë Ministër. Nepotizmi është ulur këmbëkryq. Shumica e shqiptarëve e konsiderojnë nepotizmin dukuri negative, shfaqur sot më egër, se nuk është luftuar sa e si duhet. Dukuria e theksuar dhe po merre masa galopante, është në sektorin publikë, por edhe në sektorin privat. Shqetësimi për nepotizmin në punësimë janë shoqëritë civile, sindikatat te ne janë memece. Mesa duket gojën jua kanë zënë me lekë pushteti i plotfuqishëm. Nuk duan të dinë se në Shqipëri është zhdukur shtresa e mesme e thënë troç ka vetëm shtresën e pasur me 10 për qind të popullatës dhe shtresa e varfër që përfaqësohet nga 90 për qind e popullit Shqiptar.

Sipas fjalorit fjala "nepotizëm" rrjedh nga italishtja "nepote", që do të thotë nip. Fjala nepotizëm ka hyrë në përdorim nga praktika e dhënies favore të veçanta, nipërve, mbesave, dhe fare e fisit. Thënë troç me nepotizëm kuptohet favorizimi i të afërmeve mbi bazën e lidhjeve të gjakut apo miqve të ngushtë. Pa marrë parasysh meritat e aftësitë e të punësuarve. Nepotizmi godet direkt të pa punët, sepse vendet e punës u jepen atyre që janë me lidhje

nepotike, ku pesëdhjetë për qind janë të pashkolluar, kjo sot ka pak rëndësi, mjafton të jesh i afërme i titullarit ose patronazhist. Këta të fundit bëjnë punën e kalecave në diktaturë. Propaganda e shtjellon me qellim të mbulojë se gjoja këto nuk janë si lufta e klasave. Nuk ka pasur brirë, lufta e klasave. Ajo për të marrë një vend pune, kur ishe me biografi të keqe, kishte vetëm një rrugë: Të bëheshe spiun i sigurimit të shtetit ose të vazhdoje në punët më të rëndomta. Po tani nuk hynë në punë shkollimi, aftësitë profesionale. Nuk mund të punësohesh sa do i aftë të jesh po nuk u pranove në partinë e patronazhisteve. Opozitarët nuk mund të punësohen se, nuk kthehen majtas sot dhe nesër djathtas. Institucionet përkatëse, siç është Drejtësia apo mediat, sidomos ato investigative, të cilat nuk janë blerë, duhet

aspektin e punësimit të njerëzve, pa meritë dhe pa përmbushjen e kriterëve konkurruese, nuk duhet të habitemi, pse sot kemi një ekonomi të pa zhvilluar dhe rini të pa punësuar, ekonomi të vjedhur e të masakruar. Demi ekonomik i largimit nga puna për këto vite që qeverisemi nga rilindja është me mijëra e mijëra deri edhe me miliona lek, të cilat paguhën nga taksat tona. Në çdo vend demokratik ato do të dëmshpërbleheshin nga urdhëruesi i largimit nga puna, padrejtësisht.

Le të kthehemi para tre dekadave!

Lufta e klasave ishte në kulmin e saj. Ata me biografi të ashtu quajtur "të keqe", nuk mund të pije kafe, pa lere të hynin e të dilnin në shtëpitë e tyre, se Brenda 24 orësh do mblidhej organizata fame keqe e frontit e do të diskutimesh ky veprim. Shyqyr që sot nuk kemi organizata të tilla me emër, por këto i kemi në hije me emrin patronazhist, të cilët nuk raportojnë në polici, por tek titullar dhe brenda pak ditësh ai largohet nga puna me motivacion të rrem, për "Mangësi në punë!". Pas përfundimit të revolucionit borgjez, Linkoln theksoi "Vendi do qeveriset me drejtësi, pa keqdashje për askënd"

Në diktaturë ë kishim në një front, shtetin diktatorial, me te gjitha mjetet e shantazhit e terrorit (polici, prokurori, sigurim i shtetit, gjykata burgje e kampe internimi). Po sot duke, përjashtuar SPAK-un. Të gjitha, këto institucione, janë në një dorë, duke përfshirë këtu edhe parlamentin (kuvendin e Shqipërisë) Në qoftë se thoshin Diktatura e Proletariatit, tani themi mos guxoni të kërkonit të drejta siç janë: komisione hetimore parlamentare, interpelanca në parlament me qeverinë e të tjera. Nuk përmendet diktatura e proletariatit, por të thonë kemi 83 mandate, është e vërtetë ajo që thonë. Po si u fituan? E thonë të gjitha institucionet prestigjioze Evropiane e në SH B A, se votimet ishin tërësisht të manipuluar. Në sistemin që kujtuam se e lamë pas "Thuhej se lufta e klasave, here ngrihet e here ulet, por kurrë nuk shuhet, ecën me zezake"

Në vitin 1992 intelektual të shquar shqiptar, menduan se erdhi koha që politika shqiptare të largohet nga urrejtja që kishte mbjellë politika e luftë së klasave dhe të ndiqej një politik humane. Për të realizuar pajtimin midis persekutoreve dhe të persekutuarve. Pra, për të arritur paqësisht tek uniteti kombëtar, aq i nevojshëm për popullin tone, të përçarë nga ideologjia komuniste. Kjo luftë vijon edhe sot, duke gërryer shoqërinë shqiptare si kanceri.

Kjo luftë, pas vitit 1992, kur u ndruan pushtetet ka qenë dhe është absurd. Atë e mban gjallë plani "Katovica", i cili duhet shkatërruar, se bashku me klasën e korruptuar politike, nga mendësia e luftës së klasave dhe korrupsioni. Përndryshe populli, sidomos ajo pjesë e vogël e rinisë, që nuk ka shkuar në vende të ndryshme të botës, të ngrihen me një lëvizje të re më serioze e më të programuar demokratike se lëvizja e studentëve e vitit 1990, për të hequr qafë e zhdukur tentakulet e luftës klasave.

**Ndue Ziçi,**  
**Lezhë Janar 2026**

të merren me luftën kundra nepotizmit. Duke aplikuar politik të rreptë kundër këtyre fenomeneve. Organizohen konkurse e shpallen formalisht, se ka me qindra raste kur personi ka filluar punë pa u shpallë konkursi.

Prandaj duke marrë parasysh shkeljet e ligjeve që janë bërë në aspektin e punësimit të njerëzve pa merita, dhe pa përmbushjen e kriterëve konkurruese, nuk duhet habitur pse sot kemi një ekonomi të pazhvilluar dhe rini të papunësuar, ekonomi të vjedhur e të masakruar. Nepotizmi ka ndikuar të kemi administrate të dobët në institucionet tona, të kemi korrupsion, hajni, keqpërdorim të mjeteve e të mirave material. Le të kthehemi te titulli i këtij shkrimi. A nuk janë tentakula të luftës së klasave?. Kur pa pike fytyre titullari i institucionit i thotë nuk të marrë në punë se nuk ke votuar, punuar për mua dhe subjektin që përfaqëson. Madje shkon edhe më tej, brenda radhëve të tyre, punonjësve u bëhet presion, pse nuk i bëjnë lajkë titullarit! A ka gjë më absurd? Të nën shtrosh punonjësit, me heqjen e bukës gojës të fëmijëve.

Kur bëhen rotacione të pushteteve, menjëherë fillon gjuetia e shtrigave, duke larguar nga puna personelin administrative pa pyetur për aftësitë profesionale, vetëm se mendohet se ka prirje të tjera politike. A nuk është kjo një luftë klasash, që zhvillohet në institucionet qendrore e vendor. Në saje të këtyre prirjeve, emërohen persona të pa aftë, të pashkolluar, vetëm besnik për të firmosur, në favor të shkeljeve të ligjeve, duke lënë dorë të lire hajdutëve dhe krimineleve. Duke marrë parasysh shkeljet ligjeve që janë bërë në

# Një jete me vlera e Pjeter Preke Njemzës

Te flasësh për historikun dhe për plejadën e burrave me vlerë të Gimajve të Dukagjinit do të duhej një kohë e gjatë dhe punë e mundimshme kërkimore gjë për të cilën po punohet prej disa vitesh. Kjo e shtrirë në shtratin shumëshekullor, ku zanafilla e personaliteteve të njohur të Gimajve fillon me Vatë Lekë Gjokën i cili me aktin e tij heroik sakrifikoi jetën për të mbrojtur nderin e dinjitetin jo vetëm të Dukagjinit por të gjithë malsisë dhe shkollës në kohën e pushtimit turk.

Në vijimësi bijtë e Gimajve kanë marrë pjesë në luftat shekullore kundër armiqëve të vendit tonë. Disa prej tyre kanë përfaqësuar dukagjinin dhe malësinë në takime kombëtare dhe ndërkom-bëtare, në Kancelaritë Europiane dhe në takimet në Vatikan me Papën si dhe Franc Jozefin në 1917. Bijtë e Gimajve kanë lënë gjurmë të pashlyera në historinë kombëtare. Kjo vazhdimësi është e spikatur dhe ka lënë gjurmë në fushën e dijes me personalitete të shkencës, artit, sportit dhe kulturës kombëtare. Burrat e Gimajve kanë përfaqësuar vendin edhe vitet e fundit në organizmat ndërkombëtarë, si në forcat e armatosura të NATOS dhe në organizmat e tjera ndërkombëtare.

Nga ky truall lindën u rritën dhe spikatën personalitete të sportit shqipëtar duke bërë Shqipërinë të njohur në arenën ndërkombëtare në këtë fushë. Bijtë të këtij trualli ishin ata sportistë elitare, "Mjeshtër të Mëdhenj" që sollën futbollin për herë të parë në shqipëri, duke krijuar ekipin e parë të futbollit shqipëtar, "Vllaznia" dhe më pas "Tirana" dhe "Elbasani". Lindi gjyqtarin e parë të FIFA-s në shqipëri dhe ndër të parët në ballkan. **Është një rast unik i papërsëritshëm që nga një familje e Gimajve të dalin intelektual të niveleve europiane, personalitete të njohur si: Famullitari i parë i Shkodrës. Profesor i parë i agronomisë shqipëtare. Aktor i njohur i skenës dhe ekranit. Profesor i kompozimit shqipëtar. Mjeshtër i koshit i cilësuar më i miri i shekullit. Motra e tyre 13 herë kampione e Shqipërisë në basketboll. Gratë dhe vajzat e Gimajve janë shquar ndër breza për vetitë dhe virtytet e tyre deri në ditët e sotme. Lindën artiste, aktore dhe mjeshtër të skenës dhe ekranit. Lindi "Miss Bukurinë" duke u shpallur ndër vendet e para të globit.** Lindi dhe rriti të parin nënkampion bote, djalin e personazhit të shkrimtari tonë. Për të gjithë këto personalitete e shumëçka për historinë do ti gjejmë siç thamë më lart në një libër dedikuar Gimajve. Këta djem e bija artiste të njohura edhe sot janë si një burim i pashtrësishëm në vijimësi nëpër vendet e europës e botës ku ata jetojnë, punojnë dhe kontribuojnë.

Nuk dua të ndalem në bukuritë e tij dhe as në objektet e trashëgimisë kulturore apo natyrore të papërsëritshme si Kisha e Gimajve, Syri i Kaltër i njohur si "Pusi i Kol Gjonit", Lejthia e Koçekut të Tisit unikalë në botë. Guri natyror me Kryq i përmasave të mëdha, apo gjurma e Shenjtë po në gurë e të tjera.

Në qoftë se flasim për talentin e

mjeshtërisë së ndërtimit të njohur jo vetëm në Dukagjin, por edhe më gjatë, patjetër një vend të spikatur zen edhe PJETËR PREKE NJEMZA. Nuk bëhet fjalë për një personalitet të spikatur të kësaj fushe me dije shkencore, nuk mbaroi ndonjë fakultet ndërtimi apo projektimi dhe as ndonjë kualifikim në shërbim të këtij zhanri të preferuar botërisht. Në këtë zeje spikati duke konkurruar vetëm me vetveten, ku pasioni dhe talenti ishin pronë e tij.

"Akademia" e tij ishte fantazia, dora e artë, përkushtimi dhe durimi, të cilat i shprehi nëpërmes çekicit, qeserit, daltës, mistrisë, gëjanës, nivelit, peplumbit si dhe veglave të tjera si motra të prodhuara në mënyrë artizanale nga kovaçët sipas kërkesës së tij. Ky formim i trashëguar nga brezat ja rriti vlerat duke e bërë mjeshtër të njohur popullor. Këto vlera ishin në unison me mjeshtërinë, ku u rrit dhe u perfeksionua.

Burrëria, ndershmëria dhe shkolla autodidakte e jetës, përshtatshmëria dhe luajaliteti me njerëzit ishin në harmoni me ambientin dhe kohën që kaloi. Jeta nëpërmes sfidave të panumërta të maturon, të rrit vlerat dhe virtytet duke rritur dhe formuar karakterin, personalitetin dhe identitetin njerëzor. Ka individë të spikatur në publik të cilët janë shërbëtorë që sjellin vlera në shërbim të shoqërisë. Këta janë misionarë të vërtetë për komunitetin dhe shoqërinë ku jetojnë dhe punojnë, duke ju shërbyer të tjerëve si individë me shumë vlera.

Pjetër Prek Njemza lindi në Gimaj me datën 09.09.1937. Fëmija i parë i Prek Ndout e Zojë Martines. Ishte filizi i parë i një familjeje me shumë tradita farë e fisnore e përbërë nga njerëz të besës, bujarë, mikpritës e shumë punëtorë. E mëkëmbur për kohën duke u veçuar nga të tjerët, dhe për rrjedhojë regjimi i kohës për mundin dhe djersën e derdhur, të cilët dolën jashtë "perimetrit", në vitin 1952 i shpalli kulakë. Pas ndarjes nga trangu i shtëpisë së Nike Marashit nga Radoja në vitin 1954 ndër-tuan shtëpinë në lagjen Rragam të Gimajve. Gjithë jetën Preka tregojë mirënjohës familjeve të Nikushajve, duke veçuar Lulash Prekën dhe vllazninë e Buqvatajve pranë shtëpisë së tyre, për ndihmën dhe mbështetjen e treguar karshi familjes së tij.

Përveç rrethit të gjerë familjar e miqësor, kjo shtëpi duke u gjendur në pozicionin e rrugëkalimit me Qafën e Boshit që lidh Pultin me Bregun e Lumit (qendër e Dukagjinit), e Nikaj Mërturit, Thethin e Malësinë e Madhe, ishte derë e hapur dhe treveze e shtruar për çdo mik apo kalimtar të rastit, shumë prej tyre të panjohur.

Studiuesja britanike, Edith Durham, mikja e Shqiptarëve dhe simpatizuesja e Dukagjinit jo më kot shprehej, se nuk mund të gjendet një popull në glob në varfëri ekstreme e të pashkolluar, që shquhet për besnikëri, mikpritje dhe inteligjencë si populli i Dukagjinit. Një derë e tillë ishte edhe ajo e Nik Marashit, paraardhësit e Pjetër Njemzës. Në vitin 1908 për dy muaj ajo qëndroi pranë oxhakut të kësaj shtëpie kryesisht në odën e bur-

rave, duke shkruar faqe nga ditari i saj, dhe gjatë ditëve duke ndihmuar gratë në punët e përditshme. Ajo kthehet përsëri pas dy vitesh pranë këtij oxhakut nga i cili ruajti aq shumë mbresa. Fotoja e saj me pjesëtarët e familjes së Nike Marashit ruhet prej tyre edhe sot e kësaj dite si relike e çmuar.

Kontributi i kësaj familje ka qenë me vlerë edhe në luftë për mbrojtjen e trojeve kundër serbo-malaziasve dhe në luftërat e mbrojtjes së Plavës dhe Gucisë në vitin 1944. Djemtë e Gimajve, duke iu bashkuar me Djelmnisë së Shalës dhe të Shoshit të spikatur për trimëri dhe vetëmohim të drejtuar nga Gjin Leka i Buqvatajve dhe Sokol Marashi i Radojës, vëllai i Nikës (kushëriri i Pjetrit). Janë pikërisht këta dy burra tek të cilët spikattë edhe besa e dhënë, duke marrë në mbrojtje, në besë oficerin gjerman të plagosur në prag agonie, në shtëpitë e tyre. Kjo vepër besnikërie e humanizmi do tu kushtonte shtrenjtë këtyre dy familjeve nga regjimi i kohës. Ishte urdhri i komandantit të operacionit ushtarak Mehmet Shehu, i cili me ndërhyrjen dhe ndërmjetësinë e Gjon Marashit të Shoshit dhe garancia e Prek Ndout (baba i Pjetrit) dhe kushëririt Fran Kole Pepçi, që pas 6 muajve në arrati, Gjin Leka dhe Sokol Marashi të liheshin të lirë, ndërsa oficeri gjerman të amnistohet. Kjo ngjarje ndodhi në pranverën e vitit 1945. Këtë besë dhe besnikëri, Ndue Cukeli autor i librit "Ndihmo Zot e Ora e Shalës", (ku titulli i këtij libri është marrë nga autori si shprehje hyjnore), ai këtë ngjarje e përkufizon: "Kjo ishte besa e Zotit e dhënë nga burrat e Gimajve të Shalës" (faqe 35).

Gjyshi i Pjetrit, Ndue Pjetra ishte një burrë i spikatur jo vetëm në Shalë, por në të gjithë Dukagjinin. Ai shquhej për maturi, besnikëri e burrëri, kontributi i tij në pajtimin e gjaqeve e mosmarrëveshjeve ishte i spikatur. Bashkëshortja e tij Rushe Delia vinte nga një derë e fisshme e Nikaj-Mërturit, të cilët lindën 7 fëmijë nga të cilët vetëm dy i mbijetuan epidemisë së kolerës.

Preka (baba i Pjetrit) asokohe ishte vetëm 12 vjeç. Tek ky fëmijë spikatnin shumë cilësi burrërore dhe dallohej si hokatar i veçantë, i cili humorin e improvizonte në çast. I gjithë rrethi i afërm familjar e shoqëror e thërrisnin Peca, në përkëdheli. Ishte vetëm 14 vjeç kur i rambi kurriz drejtimi i shtëpisë. Gjithë jetën e shoqëroi humor, të cilin e improvizonte në çast. Një komshi i fuqishëm fizikisht i kërkon Prekës majin (varenë), por ky me humor i përgjigjet: "Nuk mund ta jap majin sepse ma shtyp!" Tjetër episod me humor: Dy rrugëtar rastit mirëpritën në shtëpinë e tij, të çorientuar nga bardhësia e borës dhe kontrasti me dritën e pishës, e cila lëshonte më shumë tym e blozë sesa dritë, filluan të shtrëngojnë duart dhe të përshëndesnin njëri tjetrin. Preka ju drejtohet: "Na jepni një herë dorën ne të shtëpisë o burrat e dheut, sepse ju patët kohë me u fal me njëni tjetrin gjatë rrugës".

Preka u bë i njohur për ndërtimin e shtëpive jo vetëm në zonën e Dukagjinit, por edhe në Malësinë e Madhe dhe veça-

nërisht në Tropojë, ku edhe sot gjenden kulla të pa amortizuara të ndërtaura nga duart e tij, një ndër të cilat edhe ajo e një politikani unikal.

Shtëpia dhe trualli i tyre quhej me fat dhe e bekuar, veçojmë një episod ngjarje e ndodhur në vjeshtën e vitit 1948, po thuajse në kufijtë e legjendës. Gjatë një ceremoni martesë, në orët e vona të natës në pikën kulmore të dasmës, shkarkon një rrufe, e cila shkruan çdo gjë, askush nuk dinte të orientohej, duke mos kuptuar se çfarë kishte ndodhur. Nga kjo ngjarje e pazakontë nuk pati asnjë viktimë. Më i dëmtuari mbeti Toma 16-vjeçari, i cili u trajtua për shumë muaj me rrallë nga një mjek austriak i ndodhur në Dukagjin. Kjo ngjarje e pazakontë u bë e njohur në të gjithë Shqipërinë.

Nëna e Pjetrit, Zojë Martinja, ishte një grua e spikatur për shumë veti e virtyte të një gruaje burrërore Dukagjinase. Zoja ishte bijë nga një familje shumë e njohur nga Gjurajt e Pultit. Ajo mbeti jetime bashkë me Prekën, motrën e mitur, ishin 3 dhe 5 vjeçe, sepse te gjithë pjesëtarët e familjes ja prenë malazet dhe duke i shkruan çdo gjë tjetër, në vitin 1915, së bashku me 11 burra të tjerë, të Gjura-jve. Këto të dyja i rriti axha i vet, i cili u bë prind shumë i përkushtuar përjetësisht.

Zoja u martua me Prekë Ndoun në moshën 17-vjeçare. Ndërsa fëmijët e Zojës ruajtën afritet dhe respekt të veçantë për dajat tashmë të vërtetë Mark e Ndok Pjetri, baba dhe axha i Fran, Nikë e Gjovalin Kodrës, vëllezër të cilët gëzojnë respekt shumë të gjerë për personalitetin, kontributin e përkushtimin në të gjithë zonën e Dukagjinit. Fran Kodra flet me një respekt të admirueshëm për nipat e mbesat e tyre.

Shkrimtari i njohur z. Remzi Lahi, Zojë Martinen ose (Jojën) siç e thërriste rrethi familjar e ka portretizuar duke thënë: "Një Zojë e vërtetë, burrëshë Dukagjini". Preka dhe Zoja rritën dhe edukuan 5 fëmijë në kushtet e një skamëllekut të jashtëzakonshëm, të cilët u bënë model për moshatarët e tyre. Pjetri, fëmija i madh, Deda një trup i cili Zoti i dha fuqinë e një dragoit, ku gjithë jetën forcën e tij nuk e ka kursyer për të ndihmuar çdokënd. Shëmbëlltyra e tyre prindërore me emër të mirë ne të gjithë Gimajt u bënë edhe vajzat Age, Mri dhe Lezja.

Zoja (Joja) si grua fisnike dhe bamirëse, shpeshherë përdorte një fjalë të urtë të saj: "Është ma me vlerë një kokërr vezë që të fal fukaraja sesa një dash që ta fal zengjini".

Një shprehje e popullit thotë: "Pas çdo burri të suksesshëm qëndron një grua e zgjuar". Kjo shprehje fatmirësisht ka shkruar në unison të Pjetrit me Dranen, e bija e Fran Mican Çarkut nga Thethi, një familje aq shumë e njohur. Merita e këtij çifti qëndronte edhe në faktin e rritjes, edukimit dhe mirë shkollimit të fëmijëve të tyre. Për Ndojen, fëmijën e madh për aftësitë e tij të njohura botërisht do të ndalemi më pas. I dyti Marashi i shquar me aftësitë dhe talentin e tij është i njohur në Tiranën metropolitane. Lula një politikane karriere dhe ish drejtoreshë e Partit të Durrësit nga viti 1998-2002. Leka i

cili ka mbaruar fakultetin ekonomik, prej shumë vitesh është specialist i njohur në drejtorinë e taks-tatimeve në Tiranë. Fëmija i vogël, Zoga zemërbardhë dhe me një paraqitje fizike përtej një missi apo modeleje.

Pas shkollimit 8-vjeçar në Gimaj këta vazhduan shkollimin e mesëm në Breg të Lumit (qendër e Dukagjinit) një shkollë e mesme që asokohe ishte e veçuar jo vetëm në rrethin e Shkodrës, por edhe në nivel republikan, fituese e shumë evenimenteve kombëtare, me një trup arsimor thuajse të papërsëritshëm, ku një pjesë e stafit arsimor dhe ish nxënës të saj u bënë specialistë dhe kuadro drejtuese deri në rreng republikan. Për të shkuar në shkollë u duhej të përshkonin çdo ditë mbi 3 orë rrugë në këmbë, veshjet ishin pak më ndryshe nga bashkëmohatarët e tyre për fukarallëkun e kohës. Problemi madhor i tyre ishte që me trupin e tyre të mbronin çantat nga shiu për të shpëtuar librat pa u lagur.

Në librin "Maratonomaku nga Shkodra" kushtuar elitës së sportistëve të tapetit shqiptar, shkrimtari dhe studiuesi i njohur Riza Lahi (në faqen 312) do të shprehë: "Dranja, një grua e fortë, e cila bënte edhe punët më të rënda të burrave krahas atyre të shtëpisë deri në përsosmëri, duke gjetur edhe kohën që me shumë pasion të kujdesej edhe për lulet e saj rreth shtëpisë e në veçanti për karafilat e trëndafilat e moçëm me shumë aromë, për tu pasur zili edhe nga zonjat e qytetit". Dranja personifikon një grua me durim të jashtëzakonshëm.


Mbi 4 dekada më parë kjo, duke qenë dasmoreshë, teksa shoqëronte nusen, nga disa të shtëna me armë zjarrit në kulmin e dasmës, nga pakujdesia një plumb i përshkon femuralin e djathtë tej për tej. Reagimi i saj ishte i pabesueshëm. Askush nuk e kuptoi çfarë kishte ndodhur, por pas shumë minutash, Dranja me delikatesë shkëputet nga nusja për të imobilizuar plagën me mjete rrethanore, e cila rrjedhtë rreke gjaku, për të vazhduar shoqërimin e nuses sikur nuk kishte ndodhur asgjë dhe pa e kuptuar të pranishmit, megjithëse dhimbja dhe hemorragjia bënte të vetën.

Një rast tjetër që tregon durimin e pazakonshëm: Plot 42 vjet më parë më vjen në klinikë dentare duke insistuar që urën metalike të thyer ta saldoja në gojë, sepse mungonte materiali për protezë, unë i shpjegoja se ishte veprim i paimagjinueshëm, por përsëri ajo këmbëngulte në durimin e saj.

Fëmija i madh i Pjetrit dhe Dranes i lindur në Gimaj më 17 Tetor 1962, Ndoja sapo mbaroi studimet e mesme shkëlqyeshëm për arsye hijeje në biografi siç cekëm më sipër nuk mund vazhdonte studimet e larta. I shëndetshëm dhe muskolor, në moshën 15-vjeçare i thyente krahun çdo burri në Gimaj. Pamundësia e vazhdimit të studimeve të larta e shtyn të largohet i dëshpëruar nga vendlindja drejt Shkodrës, ëndërro e tij fëmijërore të bëhej shkencëtar nuk u realizua, e cila doli edhe përtej sirtarit. Tashmë sporti thuajse i mbeti në dorë. Kujtimet rimore mi tregonte shpeshherë teksa rrinim në shtëpinë time, në lagjen "Skënderbeg", duke pasur një afrimitet familjar. Në Gimaj shtëpitë tona i ndan vetëm një burim i veçantë uji. Gjithnjë Ndoja tregon se: "Gjatë orëve të vona të natës i etur aq shumë për dije qën-

droja pranë televizorit "Iliria" të familjes suaj, ky ishte si "dallëndyshja" e parë e dijes në Dukagjinin e porsa elektrifikuar. Jam gjithmonë mirënjohës nanës tuaj, Drane, në jetën e përtejme e cila teksa me zinte gjumi pranë ekranit ajo më mbulonte, duke më strukur mbi minder deri në mëngjes.

Historia e përpjekjeve të tij dhe rrethanat nëpër të cilat ka kaluar janë përtej besueshmërisë dhe mund të shërbenin si skenar i vlefshëm për filma horror, si i paimagjinueshëm për brezin e sotëm, apo si përrallë nga e kaluara. Ndoja asokohe thoshte se: "Nuk ka njeri në botë që donë me hëngër bukën, që fiton tujë u rrahë". Kushtet e stërvitjes, ushqimi e shumëçka tjetër asokohe ishin tepër të papërshtatshme për tu bërë nënkampion bote,



gjë për të cilat sot, për sportistët elitare do të ishte e paimagjinueshme, si përrallë me mbret.

Për të folur për Jetëshkrimin e Ndojës, në këtë shkrim është e pamundur, për të cilën është folur e shkruar gjatë. 4 vite radhazi si sportisti më i mirë në Shqipëri. 12 vite kampion mundjeje pesha super e rëndë, nënkampion bote, fitues i 13 medaljeve, i shumë turneve, olimpiadave evropiane e botërore. Ai me gradën "Major" në vitin 2002 caktohet shoqerues i kryeministrit Fatos Nano. Ndoja, është një personalitet, i cili ka nderuar jo vetëm Gimajt, Dukagjinin dhe mbarë Shqipërinë dhe të gjithë Shqiptarët nëpër botë, për të cilin është folur dhe shkruar gjatë dhe rapsodë të njohur i kanë kushtuar këngë, në njërin prej të cilave poeti shprehet: "Shumë sportistë ka rritë kjo tokë, me Ndue Njemzën i dyti në Botë".

Prej një çerek shekullit është familjarisht qytetar i Miçiganit së bashku me bashkëshorten Luljeta dhe djemtë Renaldo e Andri, gëzojnë respekt jo vetëm në bashkësinë shqiptare, por edhe të kombësive të tjera. Ndonëse i ndajnë 8000 kilometra, zemra ju punon për vendlindjen. Relika më e çmuar të cilën e mban gjithmonë në qafë është kryqi prej arit dhuruar nga gjyshja Zojë (Joja), përpara se të largohet nga jeta tokësore, në vitin 2000.

Lula e diplomuar në fakultetin ekonomik, kandidon si e para femër në Du-

kagjin për deputete në vitet pas pluralizmit në siglën e partisë Social-Demokrate, por mbrapsitë e atyre viteve nuk pyesnin për meritokraci. Lula, e cila ka respektuar dhe ndihmuar haptazi çdo malësor, shkodran e verior, i cili i është paraqitur rasti, shpeshherë punonjësit teksa dëgjonin dialektin verior të pasagjerëve shprehin njeri tjetrit se duhet të jetë "njeri i drejtoreshës". Karakteristikë e veçantë e saj janë batutat me humor pa u ndalur edhe në takime direkte me drejtuesit më të lartë të shtetit. Këto batuta ishin dhe vazhdojnë të jenë edhe sot në qarkullim në kafenetë e Tiranës, shumë prej tyre edhe personifikoheshin me emrin e saj. Shpeshherë ajo në vend të masës disiplinore për vartësit e saj përdorte si ndëshkim humorin e improvizuar sipas rastit. Lulën sa herë që e

pyesin njerëzit jashtë Tiranës për punën apo vendbanimin ajo me humor u përgjigjet: "Si profesor doktor Zef Gjeta" duke nënkuptuar sloganin e tij të kahershëm: "Jam emigrant ekonomik në Tiranë". Nga trualli Pjetër Prek Njemzës lindën dhe u rritën njerëz të zgjuar e të njohur si inxhinierë, avokatë dhe mjeshtra të veçuar të shpërndarë nëpër Evropë dhe përtej Atlantikut. Secili më fisnik se tjetri duke përcjellë dhe trashëguar tiparet e virtytet më të mira të oxhakut të breznajes.

Pjetri si mjeshtër e specialist për shumë vite punoi në reparte ushtarake ku përveç talentit e karakterizonte korrektësia e ushtarakut. Duart e tij të arta thuajse nuk kishin konkurrent, talentin e pati në gjeneze dhe të trashëguar nga babai i tij Preka. Pjetër Njemza shquhej për shumë veti e virtyte të larta për zemërgjerësi, bujari e besnikëri si dhe dashurinë për të gjithë, këto bënin që të plotësonin edhe shkollimin e munguar. Fjala e tij e matur e thënë urtë e butë të jepte përshtypjen e një personi të mirë shkolluar. Ishte një protagonist i spikatur i një epoke ku puna ishte nder, ku individë të kësaj kategorie respektoheshin dhe nderoheshin nga të gjithë. Ndërsa sot respekti për punën është venitur në mënyrë të tejshkajshme, sot luftohet vetëm për fitimin në çdo formë e mënyrë. Asokohe mund të themi se munda dhe djersa nuk shpërblehej materialisht por konvertohej me respekt dhe dashuri. Një ish kolegia ime mjek stomatologje Anica Vujoshi përdorte një shprehje unikalë në mënyrën e vet, kur flitej për dashurinë dhe përkushtimin për punën ajo thoshte: "Kjoftë për atëherë".

Asim Zeka, Komisar Brigade dhe deputet i Dukagjinit thoshte: "Pjetër Njemza është një burrë fisnik dhe punëtor i spikatur, i cili personifikon Gimajt, mjeshtër i lindur dhe njeri i respektuar".

Ndërsa Shaban Fyraj, një oficer i lartë nga Fieri, i cili asokohe drejtonte punimet xheniere, duke u shprehur me respekt për Pjetrin dhe për talentin e tij thoshte: "Fantazia në ndërtim, dashuria për njerëzit dhe korrektësia e bëjnë Petron (Pjetrin) njeri unikal në llojin e vet".

Duhet thënë se ndarjen me familjen dhe të afërmit ai e konceptoi prej pak kohësh, si një burrë i pa përkulur si "Lisat

e Radojës", nën rrënjët e të cilëve buron një ujë i veçantë, i rritur nën hijen dhe me aromën e tyre, me paraqitjen stoike dhe zemrën që rrezatonte bamirësi.

Ishte një kohë e shkurtër që ishin ndarë me bashkëshorten Drane nga jeta tokësore, Pjetri la pas vëllën e motrën, djem e vajza, nipa dhe mbesa nga Shkodra në Tiranë, nga Evropa e deri përtej oqeanit, me emër te mirë të cilët kanë të drejtë të mburren për të parët e tyre. Ata ndihen krenarë për babanë dhe lisanjën e tyre.

Një shprehje e urtë thotë: "Le të vdesë jeta e një njeriu dhe kjo ditë do të ndodhë për të gjithë, por mos të jetojë përjetësisht vdekja". Pjetri jeton në kujtesën tonë falë vetive e virtyteve të spikatura të kujtesës njerëzore. Megjithëse ka kaluar viti që ai fizikisht është larguar prej jetës tokësore, na duket sikur përsëri gjendet mes nesh, por shpirti i tij pushon në paqe. Se do të vinte një ditë largimi secili prej nesh e dinte si një britmë në boshllëkun që la pas. Me gjithë kohën e gjatë që jetoi në Tiranë atij mendja dhe zemra i punonin për vendin e tij Gimajt e Shalës. Ai shpeshherë thoshte: "Çdo herë që dal atje rinohem dhe marr energji, dhe se çdo ëndërr që shikoj ka vetëm një adresë, Gimajt, Shalën e Dukagjinin". Ai kishte një ëndërr, një dëshirë të cilën e la amanet, që trupi i tij të pushonte pranë të parëve të vet, përballë Kishës së Gimajve dhe kështjellës mesjetare të legjendave. Megjithëse varrin e tij nuk arriti ta shikonte sa ishte gjallë besoj se i plotëson të gjitha parametrat që ai i dëshironte, sepse shijet e tij dhe të fëmijëve ishin në unison.

Poeti e publicisti Prel Milani publikoi një nekrologji, ku ndër të tjera shprehë: "Ishte një njeri shembullor, një mjeshtër i spikatur, i cili i jepte çdo punë një ndjesi përsosmërie dhe sakrifice. Ai ka lënë një shenjë të pashlyer në jetën e atyre që e kanë njohur dhe kujtimi për te do të mbetet i pashlyer. Paraqitja e tij elegante, trupgjatë me veshjen e tij të spikatur, bisedat me maturi e urtësi të jepnin përshtypjen e një profesori apo zyrtari të lartë. Ishte bashkëkohor i emancipuar me sjellje burrërore dhe dinte të jetonte me dinjitet. Mbante shënime dhe ditar sikur të ishte një kronikal i kohës. Sa për babën e tij, Prek Ndou e familjen që la pas, e brezinë homerike, pasardhësit e tij janë të njohur edhe në nivel botëror si të veçantë".

Ceremonia mortore u zhvendos nga Tiranë në Shkodër. Dukej sikur merrte pjesë gjithë Dukagjini dhe Shkodra, njerëz të moshave dhe profesioneve të ndryshme, për ti dhënë lamtumirën e fundit. Ndërsa varrimi në Gimaj ishte i një dimensionit të veçantë, duke tejkuluar pritshmërinë. Autokolona të pafundme të makinave të befasonin me pjesëmarrjen e tyre. Binte një shi i butë i ndërthurur me rrezet e diellit ku mbi Kishë dhe Kështjellë shfaqej "harku" i ylberit. Ishte një pamje vërtet magjepsëse. Dukej se Zoti po afronte njeriun e vet të bekuar. Ne i dhamë lamtumirën, por duke menduar se përsëri ishte pranë nesh. Një ceremoni e tillë i shkon për shtat një njeriu të spikatur si Pjetër Prek Njemza!

Shpirti i tij prehet i qetë në jetën jashtëtokësore!

**MARK BOBNAJ,**  
mjek stomatolog dhe studiues

# Mësuesi Kin Gega, një Meteor që u shua para kohe

Nuk e di se ku e kam lexuar, por shumë yje shuhën në mëngjes. Shumë mendje të ndritura largohen para kohe nga kjo botë...

Në fund të dhjetorit të vitit 2024, diku lart në bjeshkët e Berishës së Epërm të Pukës, piskati zana:

— Oooo, ka vdek Kin Gega mooooreee!

A i keni pa yjet që bien nga qielli në agim të hershëm, sa shumë ndriçojnë? Njashtu pra, tu nda dita me natën, pak pa u ndërrua vitet, shpirti i një burri mendjendritur u ngrit në qiell.

Ndoshta krejt rastësisht, ato ditë isha në Pukë. Në çdo tavolinë kishte vetëm një bisedë: ka vdek burri fisnik nga Berisha e Epërm.

Kam njohur vëllain, por edhe një nga motrat e tij. Kam takuar shumë miq dhe kolegë të tij dhe, sa herë dola në ato anë, emri i tij, madhështia e tij, kujtimet e tij zbritën në tavolinat tona.

Në kullat kreshnike, me rrënjë të thella bese, burrnie dhe patriotizmi, gjithmonë dalin vlera dhe burra që lanë gjurmë. Stërgjyshi i tij, Geg Sokoli, ishte pjesë e kuvendit dhe firmëtar i një marrëveshjeje të rëndësishme në vitin 1867 mes Trovnit dhe Merturit.

Me ato histori dhe legjenda, me atë dashuri dhe patriotizëm, u rrit dhe u gatua mësuesi vizionar Kin Gega. Historia ishte pjesë e jetës së çdo malësori. Letërsia, rrjedhojë e frymëzimit që të dhurojnë ato bjeshkë. Por fizika ishte pjesë e talentit universal që kishte ky mendje-ndritur.

Sa e vështirë ishte në ato vite për të ndjekur ëndrrat tua, këtë e dimë të gjithë në brezin tonë. Po kush ishte profesor Kini në rini? – e pyeta një koleg të tij.

“Shkolla e parë e secilit nga ne është familja”, – tha zotnia. Kam lexuar diku se me sa krenari dhe dashuri e portretizon babain e tij:

“Ma, se sa prindi ndihet krenar për bijtë e vet, unë ndihem krenar për tim atë, punëtor i palodhun, i shoqërueshëm, i këngës dhe i kuvendit, i kudo e kurdogjetun për shokë, miq e nevojtarë.”

Ndërsa gjyshin e tij, Kol Gegën, e konsideronte si mësuesin e parë.

I rritur në një familje me tradita të veçanta bese, bujarie dhe patriotizmi, Kin Gega do të bëhej shumë shpejt një pikë reference për të gjithë brezin e tij. Qysh në rini, ai ishte sfidant i regjimit, një pishtar i mendimit të lirë. Nuk u josh kurrë nga lakmia për pushtet, duke mbetur gjithmonë një avokat i së drejtës dhe krah i të varfërve.

Në familjen e tij, në vendlindjen e tij, Kini kishte mbaruar Universitetin

njerëzor të traditës, kulturës dhe burrnisë. Por, duke qenë një talent i lindur, duke pasur një prirje të veçantë për gjëra të sakta dhe perfektë, zgjodhi të studiojë shkencat ekzakte dhe të diplomohet për fizikë. Fizika për të nuk ishte thjesht profesion, por një mënyrë me kuptua rendin e botës, me eksplorua hapësira të lira dhe me fitua mbi atë terr informativ ku ishin zhytur trojet shqiptare, sidomos zonat e thella.

Ja si shprehet Zamira, ish-nxënëse e tij: “Lamtumirë, mësues i dashur i qindra nxënësve të shkollës Iballe.

Mësuesi rebel, që falë përgatitjes së lartë shkencore dhe shpirtit të tij të lirë, nuk pyeste për ligje e rregulla. E kush nuk e njihte mësuesin e dashur të fizikës, që shpjegonte aq bukur ligjet e Njutonit, që ndërtoi kabinetin e fizikës, model në të gjithë Shqipërinë. Mësuesi që nuk shpjegonte kurrë pa bazë materiale të krijuara vetë ose nga nxënësit e tij. Mësuesin që të bënte të qeshje me batutat e tij dhe njëkohësisht ta shpjegonte aq thjeshtësisht mësimin, saqë edhe nxënësi më i dobët e ndiqte me vëmendje dhe interesin më të madh. E kush nuk e mban mend mësuesin e paanshëm, që nuk donte t'ia dinte nëse ishte fëmijë drejtori, sekretari partie, kulaku, pasaniku apo fukaraje. Nota e tij ishte vlera reale e dijës dhe nuk pranonte kompromis me askënd e me asgjë. Mësuesi dhe intelektual që e urrente komunizmin dhe që e kundërshtoi hapur ende pa ardhë demokracia. Intelektuali i kulluar e demokraci i flaktë, që shpresonte aq shumë në ndryshimin e sistemit dhe që po aq shumë u zhgënjye nga e djathta që mori pushtetin. Ky zhgënjim e detyroi të merrte rrugët e kurbetit si mijëra të tjerë intelektualë, që besuan në një Shqipëri tjetër (që fatkeqësisht nuk e kemi as sot).

Mësuesi i mirë, që në shtetin fqinj u mor me studime antropologjike dhe u ngrit në nivelet më të larta të shkencës. Mësuesi që fliste e shkruante në një gëgnisht të kulluar, sot paska marrë rrugën drejt qiellit.”

Një Zot e di se sa sfida duhej të kalonte një student nga Berisha e Pukës, nga një familje malësore, për t'u diplomuar ekselent në atë fund-epoke.

Këto ditë ai ka përvjetorin e ndarjes nga jeta. Kam lexuar në rrjetet sociale shumë komente, opinione dhe vlerësime.

Në klasë nuk shpërndante vetëm formula, por siguri mendimi, drejtësi dhe besim. I aftë, i drejtë dhe kërkues. Ai ruante të njëjtin standard për të gjithë. Në shkollën e mesme të Iballe ka lënë gjurmë të përjetshme për korrektësi, profe-

sionalizëm, kulturë e burrni.

Ja si i përjeton dhe si i përshkruan emocionet, kur katër nxënës nga shkollla e tij fitojnë medalje në një konkurs mbarëkombëtar:

“Ndihem krenar për punën që kam bërë në Iballe dhe... asokohe punohej me një ndjenjë të rrallë, një përkushtim të pashoq. Këta katër ish-nxënësit e mi, fitues të vendit të parë të konkursit shkencor ‘Shkenca dhe jeta’ dhe ‘Horizonti’ në Pukë, do arrinin edhe vendin e tretë në nivel kombëtar (zhvilluar në Lezhë). U kisha premtuar se do i çoja në Tiranë. Dhe ashtu u bë. Tani ju uroj të gjithëve mbarësi në jetë, kudo që ndodhen.”

Kam parë në dorëshkrimet e tij se si e ka fiksuar ai 20 shkurtin:

“...Ish e mërkurë. Turmat e revoltura kishin rrëzuar përmendoren e udhëheqësit dhe ne aty në Iballe na kishin thirrur me ngut për të treguar besnikërinë tonë ndaj partisë dhe idealeve të saj. U mblodhëm te shtëpia e kulturës. Dukej se i gjithë fshati ishte grumbulluar, e në podiumin e radhës paria politike po mbante fjalimin e rastit... U arrit deri aty të i kërkohej të pranishmëve:

‘Kush asht i gatshëm për t’u radhitur vullnetar për të shkuar në Tiranë për mbrojtjen e partisë?’

Ra një heshtje e befte dhe, mes saj, u ngrit vetëm një krah – i zoti i të cilit tha:

‘Për me mbrojt atdheun nuk kursehem, por me mbrojt këtë sistem politik, unë nuk jam!’

‘Shënoje, shënoje emnin’, – tha kryetari...’

Shumëkush ktheu sytë prej krahut të vetëm dhe morën guxim të flisnin për demokraci të fjalës. Në fakt, aty e pas, për mbrojtjen e partisë, askush nuk mori rrugën për Tiranë; tirania ua kishte prishur gjumin prej vitesh, edhe pse zanin me ua ndie nuk bahej fjalë...!

Mësuesi Kin Gega, në kulmin e energjisë që të jep moshë dhe formimi intelektual që kishte, nuk mori flakë në atë pranverë të brishtë demokracie. Profetori i fizikës ishte i bindur se demokracia është një univers me shumë galaktika, se midis asaj që thuhej dhe asaj që bëhej ishte një hendek i madh.

Po citoj një epigram që kishte vënë tek një foto me disa miq të tij:

“Urtësia e Pukës asht si copa e bukës: duhet përditë.”

Më ka bërë shumë përshtypje se sa për zemër e kishte gëgnishten. Ndoshta kjo lidhet me krenarinë fisnore, ndoshta me një revoltë të brendshme kundër padrejtësisë gjuhësore që u është bërë trojeve të

Dukagjinit të vjetër.

Ja si shkruan Elidoni, një nga miqtë e Kinit:

“Me Kinin kam biseduar e komunikuar rreth historisë, trashëgimisë sonë kulturore (sidomos asaj pukjane), gjuhës, etimologjisë e emrave të vendeve më shumë se me asnjë tjetër. Asnjë mendje tjetër nuk kam njohur të futej aq thellë në hulumtimin e shpjegimit e kulteve dhe traditave tona e t’i shpjegonte në aq mënyrë mahnitëse, të padëgjuar kurrë më parë. Bisedat tona ishin gjithmonë gëgnisht, gjithmonë pukjançe.”

Po e mbyll me një fragment gjatë bisedave tona, ku Kini thotë:

“... në malet tona janë ruajtur deri në ardhjen e demokracisë ‘fara e zgjedhur e njerëzimit’. E në këtë përzgjedhje një rol të pazëvendësueshëm ka pasur kisha. Kisha e atyre brezave kujdesej që paria të mos humbte kurrë.”

Profesor Kini dukej qartë se ishte njeri shumë i lexuar. Kjo dallohej në forcën e argumentit dhe në thellësinë e mendimit.

Ja si shprehet ai në një argument:

“Damnatie memories (dam na thie me mue ri es). Historinë tonë e kanë rrëfyer të huajt për interesat e veta. Sot, kur thuhet ato të vërteta, rezultojnë – për klanet e pushtetit – ashtu siç të parët tanë i cilësonin si dam/dëm (çarje/gjak/rrezik)... Na, me thënë (damnatie) me mue rie (memo-rie), është: me u kujtue.”

Djali i Trovnit, mendja e zgjuar e profesor Kinit, do të gjente rrugët e duhura për të shijuar jetën, por edhe për të lënë gjurmët e tij intelektuale. Kur i lexoj ose kërkoj të hy në mendimet e tij, shpirti më lodhet dhe një ofshamë e thellë më pret duart e lapsin e lëshoj mbi tavolinë. Sa dhimbje që mendje kaq të ndritura u detyruan të ikin nga Shqipëria. Është fat i madh për familjen, për shoqërinë, për kombin kur lind dhe rritet intelektual kaq i zoti, por plagë e rëndë kur largohen nga vendi e aq më tepër nga jeta.

Për të dënuar arrogancën, për të zhdukur injorancën, dhe për të jetuar shpresat, s’ka tjetër rrugë veçse: Dijes!

Për të vazhduar ëndrrat e tij, për të hapur një rrugë të re për jetën e fëmijëve të tij, mësuesi i nderuar Kin Gega, ashtu siç e kishte mësuar në fizikë, u shkëput nga “bërthama” drejt hapësirave të botës. Në djepin antik të qytetërimit të Evropës, ku do të jetonte në trinomin: Familja – puna – libri. Duke jetuar shumë vite në Romë, falë pasionit dhe mundësive që të ofron ky vend, thelloi njohuritë e tij shkencore, duke u bërë pjesë e: Le aree archeologiche Mediterranee, si dhe njohës i disa gjuhëve të huaja. Ka bërë shumë studime gjuhësore dhe historike, të cilat shpresoj se do të shohin dritën e botimit.

**Përgatiti:**  
**LULASH BRIGJA**

## REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj  
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,  
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia  
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,  
Wilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,  
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSOI BOTIMIN E  
GAZETËS N/KAMPIONI I  
BOTËS NË MUNDJE, ME  
BANIM NE MIÇIGAN,  
NDUE NJEMËZA**

